


Muhamed Muteveli Esh-Shaëravi

RRUGA DREJT AFRIMIT ME ALLAHUN

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik, 2020



NAMAZI



Është rruga për t'u afruar me Allahun, është rruga e cila largon njeriun nga harresa dhe neglizhenca.

1. Të shprehurit e dashurisë ndaj Allahut në mënyrë të përbashkët është adhurim ndaj Allahut

- Kur Zoti i Lartmadhëruar i ka paraparë shtyllat e islamit, i ka paraparë asisoj që të jenë permanente (të vazhdueshme), ashtu që të përmendet gjithmonë Zoti Një, i Vetmi.

- I ka paraparë që të jenë permanente (të vazhdueshme), në mënyrë që të përmendet Allahu dhe për të vërtetuar sinjeritetin e të dërguarit në transmetimin e shpalljes nga Zoti i Lartmadhëruar dhe,

- i ka paraparë asisoj që, afrimi ndaj Allahut të jetë i përvetshëm dhe kjo duke e shprehur dashurinë e Allahut ndaj tyre për çdo ditë nga pesë herë në ditë.

Zoti i Lartmadhëruar, takimin kolektiv e ka bërë të domosdoshëm vetëm në ditën e xhuma. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا الْبَيْعَ

“Kur bëhet thirrja për namaz, ditën e xhumasë, ecni shpejt për aty ku përmendet All-llahu (dëgjojeni hutben, faleni namazin), e lini shitblerjen.” (El-Xhumua : 9)

Zoti i Lartmadhëruar nuk dëshiron që shprehja e dashurisë ndaj Tij të bëhet vetëm individualisht, por dëshiron që shprehja e dashurisë ndaj Tij të bëhet edhe në mënyrë të përbashkët.

Mund ta shprehi dashurinë ndaj Allahut në mënyrë individuale për veten time, mirëpo me shprehjen e dashurisë ndaj Allahut në mënyrë kolektive e shprehi adhurimin tim para krijesave të Allahut, për të treguar madhështinë e Allahut. Zoti i Lartmadhëruar thotë: Unë dëshiroj që të gjithë ju së bashku të më adhuronit Mua dhe ta publikoni njëri pas tjetrit. Më adhuronit së bashku ashtu që i dobëti të shihet të fortin në sexhde, të shihet se janë të barabartë në adhurim dhe ta ndjejnë veten të barabartë edhe në jetën e përditshme. Le të mbizotërojnë mendimi se edhe i fuqishmi i Përvet Zotit dhe i nënshtrohet Atij.

Poashtu kur të mbizotërojnë mendimi edhe te i fuqishmi se tjetri e ka parë në atë gjendje (të barabartë), pra duke iu përvetur Zotit, nuk ka mundësi që të tregohet kryelartë asnjëherë. Për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar ka

obliguar që një adhurim prej adhurimeve të bëhet i përbashkët dhe ky adhurim të bëhet një herë në javë.

إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَى ذِكْرِ اللَّهِ

“Kur bëhet thirrja për namaz, ditën e xhumasë, ecni shpejt për aty ku përmendet All-llahu),” (El-Xhumua : 9)

Në namaz bëhet takimi për të madhëruar Allahun

Termi “**përmendje**” në ajetit kur’anor: “... në **përmendje të Allahut.**” tregon se ky takim të përkujton për Madhështinë dhe Lartësinë e Allahut. Kjo nga shkakut se njeriu harron, dhe kur të kalon një javë, dhe njëri është i fuqishëm, tjetri i lartë, dhe tjetri i dobët, dhe i dobëti mendon se është i dobët, po ashtu i fuqishmi mendon se është i fuqishëm, atëherë themi: Jo, Zoti i Lartmadhëruar të tregon se ti je rob dhe je i barabartë me të gjithë njerëzit sepse para Zotit je i dobët.

Dhe kur të shohësh kryetarin i cili qëndron para Allahut duke qarë, kjo skenë ndikon te ti ashtu që përderisa e ke llogaritur të fuqishëm në çdo aspekt, tani e kupton se ai është i dobët sikurse ti. Kështu pra, e ke gjetur pikën e përbashkët të barazisë.

Analizojeni precizitetin e ajetit kur’anor prej Zotit të Lartmadhëruar ku thotë:

إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا الْبَيْعَ

“...kur bëhet thirrja për namaz, ditën e xhumasë, ecni shpejt për aty ku përmendet All-llahu, e lini shitblerjen.” (El-Xhumua : 9)

Nuk do të kishte **shitje** po të mos kishte **blerje**, se përndryshe si do të ndodhte blerja.

Në procesin e shitblerjes patjetër duhet të ekzistoj:

- shitësi dhe
- blerësi.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: “**Dhe ndërpriteni shitjen.**” E ka përdorur njërin shtyllë të marrëveshjes (kontratës), e ajo është *shitja*, duke u larguar nga blerja.

Kjo nga shkakut se:

- shitësi gjithmonë dëshiron të shesë, mirëpo,
- blerësi ndonjëherë blenë se është i detyruar ose edhe kur i paraqitet oferta prej shitësit e cila ta tërheq vëmendjen për të arritur marrëveshjen e kontratës.

Blerësi kur shkon në treg dhe kur i thuhet “blije këtë se ke nevojë” deri sa të blejë mundohet të paraqet arsye time, ndonjëherë ai thotë:

“Unë kam shkuar, por nuk kishte çka më nevojitej”, ose

“Kishte po nuk më pëlqenin”, ose

“Shitorja ishte e mbyllur”, etj.

Sa i përket shitësit, ai nuk gjen arsye për të mos shitur, sepse shitja është burim i profitit të shpejtë (të menjëhershëm).

Kështu pra, Zoti i Lartmadhëruar ka nxitur aktin tregtar, shitjen mbi blerjen, sepse:

- çdo shitës dëshiron të shesë (mallin), ndërsa,

- çdo blerës nuk dëshiron patjetër të blejë.

Për këtë arsye, shohim se Zoti i Lartmadhëruar e ka përdorur çështjen më të rëndësishme të aktit. Mirëpo parashtrohet pyetja: Pse në ajet është paraparë çështja e shitjes?

(Përgjigja) E ka paraparë këtë (shitjen) sepse çdo veprim i veprimeve e ka afatin e vet:

Nëse themi: Mos i lexo librat shkollorë sepse koha e rezultatit të mësimi është në fund të vitit.

Nëse themi, mos u merr me bujqësi sepse prodhimet bujqësore realizohen vetëm në fund të vitit, mirëpo si qëndron çështja me aktin e shitblerjes? Baza e aktit të tregtisë (profiti) realizohet që në momentin e shitblerjes dhe profiti është i menjëhershëm.

Zoti i Lartmadhëruar e ka përdorur aktivitetin më të pëlqyer, e ajo është *tregtia*. E ka përdorur bazën më të rëndësishme, e ajo është *shitja*. Kjo do të thotë, sikurse të kishte thënë: **“Mos e vepro çështjen më të rëndësishme”**. Nëse të them ty mos e vepro këtë çështje e cila e sjell rezultatin pas një viti, ti ndoshta nuk do ta kishe vepruar, por Zoti i Lartmadhëruar të ka thënë: “Ndërprite (mos e vepro) çështjen e cila e jep rezultatin (profitin) që në momentin e marrëveshjes (shitjes)”.

Në xhemat, Zoti i Lartmadhëruar na tregon suksesin e tregtisë në jetë

Kështu pra, nxitoni në përmendjen e Allahut dhe ndërpriteni shitjen, ashtu që të jetë xhemat dhe shoqëri e cila e ndjenë dashurinë e ndërsjellë shoqërore.

Kjo ndjenjë ndërton shoqëri të qëndrueshme, shoqëri të qetë, në të cilën nuk ekziston kryelartësia.

Po ashtu, Zoti i Lartmadhëruar na orienton në lutje për njëri-tjetrin, ashtu që nëse e lexon Fatihanë:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١﴾ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٢﴾ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿٣﴾
مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ ﴿٤﴾ إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ﴿٥﴾ اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ﴿٦﴾
صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ ﴿٧﴾

“Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve. Bamirësit të përgjithshëm, Mëshirëbërësit. Sunduesit në ditën e Gjykimit! **Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ti ndihmë kërkojmë.** Udhëzona në rrugën e drejtë. Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, e jo në të atyre që je i hidhëruar dhe që kanë humbur.” (El-Fatiha)

Ti je ai i cili e lexon këtë sure, do të duhej të thuash (në njëjës): “**Vetëm Ty të adhuroj dhe vetëm te Ti mbështetem**”, mirëpo ti e thua (në shumës). E thua për vete dhe për tjetrin, tjetri e thotë për veten e tij dhe për tjetrin.

“**Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ti ndihmë kërkojmë..**” (El-Fatiha, 5)

Pse e kam përfshirë veten në **adhurim** në bashkësi?. Dhe,

pse e kam përfshirë veten në **kërkimin e ndihmës** në bashkësi?

(Përgjigjja) Nga shkaku se ndoshta nuk jam i sigurt se vepra ime pranohet, mirëpo kur të jem në një shoqëri të madhe, është e pamundur që në shoqëri të madhe të mos jetë ndonjë prej “**adhuruesve**” dhe “**kërkuesve**”

të ndihmës” dhe është e mundur të jetë e pranuar vepra prej tyre. Nëse u pranohet, atëherë unë e kam përfshirë veten time në atë kontratë dhe Zoti ose e pranon nga të gjithë ose nuk e pranon nga të gjithë.

Kështu pra, nëse thua **“Vetëm Ty të adhurojmë”**, i bie që veten tënde e ke përfshirë me të tjerët, e ndoshta Zoti e ka pranuar veprën e tyre. Ti i di mangësitë e tua, por kur veten tënde e fut në marrëveshjen e tyre, Zoti i Lartmadhëruar ta pranon.

“Vetëm Ty të adhurojmë”, në këtë është veprimi i përbashkët me atë shoqëri.

Ti e vëren ndonjë njeri i cili nuk e pranon programin e Allahut, por ta dish se edhe ti në disa raste je indiferent (*nuk i zbaton disa pjesë të programit të Allahut*), për këtë arsye mos e nënvlerëso dhe mos e nënçmo atë, sepse vjen një kohë që vepra jote dhe vepra e tij pranohen për shkak të njëra-tjetrës. Është në dobinë tënde kur ndonjëherë ka njerëz të cilët i kanë shkëputur lidhjet me Allahun sepse në mes tyre dhe Allahut ka respekt. Kur unë me ata themi **“vetëm Ty të adhurojmë”**, e mira e tyre është angazhimi i tyre dhe nuk lejohet dhe nuk e meritojnë që ti t’i nënçmosh ose t’i përqeshësh ose t’i ofendosh.

Kur ti i nënçmon ata, atëherë e ke ngushtuar hapësirën e vetes tënde për të pasur sukses në jetë, kështu pra, zgjeroji mundësitë e suksesit tënd, ashtu që kur ti e sheh një njeri i cili është larguar nga adhurimi, respektoje, ose së paku mos e nënçmo. Pse?

(Përgjigjja) Sepse ndoshta ai mund të krijojë hapësirë për ty për të pasur sukses dhe shpëtim, ashtu që kur i bashkëngjitesh atij, mund të ndodhë që të të pranohet vepra (për shkakun e tij).

Kështu pra, për të mirën tënde është që të jesh me njerëz të mirë. Mirësia, në rend të parë e shpie njeriun në dashamirësi shoqërore, ashtu që realizohet një lloj i adhurimit të drejtë.

Çështja tjetër e adhurimit të përbashkët është se ti prezanton në fushën (arenën) e suksesit dhe të shpëtimit. **Njeriu mëshirohet kur është në bashkësi.**

Produktiviteti i punës për të aftin dhe të paaftin

Të marrim një shembull:

Gjatë një proteste, nëse ndonjëri prej protestuesve brohorit diçka të keqe, e cila i hidhëron njerëzit, brohoritja dëgjohej, protestuesit e përsërisin. Nëse ndonjëri prej tyre arrestohet, i arrestuari thotë: **“Jo, nuk jam unë, nuk jam unë”** që do të thotë se **brohoritja** qëndron në mesin e bashkësisë (protestuese). Kështu pra, kur një ditë prej ditëve kur Zoti i Lartmadhëruar i mbledh njerëzit së bashku, në të mirën e njerëzve është që Zoti i Lartmadhëruar të na paraqet me rezultatet më të mira të veprave tona (në bashkësi).

Sa i përket përtacëve në namazin e tyre, ndoshta ata pretendojnë se namazi shpenzon kohë. Ata pretendojnë se koha e shpenzuar e namazit i pengon nga aktiviteti i jetës.

Ne i pyesim ata: Cila është vlera e kohës? Pse po vepron në kohë?

Ai përgjigjet: Që të jem aktiv në të.

Cili aktivitetit ka vlerë që prodhon produktivitet në jetë, na thuaj, a mos është *fitimi i pasurisë*?!

Atëherë ne i themi: Kështu pra, pusho dhe qetësohu.

Zoti i Lartmadhëruar e sheh se ti ke shpenzuar kohë, në të cilën ke humbur aktivitetin nga e cila do të kishe fituar të mira materiale. E njëjta vlen edhe për rastin kur ti punon dhe fiton pasuri, për të cilën Zoti i Lartmadhëruar të ka obliguar të bësh adhurim dhe të ka thënë: Prej pasurisë të cilën e ke fituar nga puna jote, një pjesë dua që ta marrë nga ti për vëllezërit e tu të dobët. Për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar e ka ligjësuar zekatin.

Besimtari i cili e lexon Kur'anin, kur e lexon Kur'anin nuk mund të sheh (lexon) në Kur'an. **“Nxjerre zekatin nëse ke pasuri”** ose **“vepro me qëllim të dhënies së zekatit”**. Ka dallim në mes të teksteve: *Jepe zekatin dhe veproje zekatin*, ose aktivizohu në jetë me qëllim të zekatit.

Si është e mundur kjo?

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ ﴿١﴾ الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ ﴿٢﴾ وَالَّذِينَ هُمْ عَنِ اللَّغْوِ مُعْرِضُونَ ﴿٣﴾ وَالَّذِينَ هُمْ لِلزَّكَاةِ فَاعِلُونَ ﴿٤﴾

**“Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët,
ata të cilët janë të përlur dhe janë të kujdesshëm gjatë faljes së
namazit,**

**dhe ata të cilët i shmangen të kotës (fjalë a punë),
dhe ata të cilët rregullisht veprojnë në dhënien e zekatit...”**

(El-Muëminunë : 1-4)

A mos Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“E japin zekatin” apo

“E veprojnë zekatin”?

Kjo nga shkaku se:

- Mënyra e shprehjes **“japin zekatin”** është për ata të cilët kanë pasuri
dhe e japin zekatin. Përderisa,

- mënyra tjetër e shprehjes **“veprojnë”**, kjo është sikurse puna jote në
jetë ka për qëllim fitimin:

- për të furnizuar veten,
- për të furnizuar atë të cilin e do, dhe
- për të furnizuar atë i cili nuk mund të punon.

Pra, ti jep prej të mirave të Allahut të Lartmadhëruar.

Në aktivitetin jetësor, një pjesë duhet të jetë në rrugë të Allahut

Kështu pra, kur ti vepron apo nuk vepron diçka, e ke në mendje për tjetrin. Ti duhet të planifikosh që të punosh asisoj që të kesh dobi për veten tënde, për familjen tënde, bile edhe për të dobëtin, sepse një pjesë e fitimit tënd është e përcaktuar për të dobëtin. Kjo vërehet në ajetin kur'anor:

“...dhe ata të cilët veprojnë për dhënien e zekatit...” (El-Muëminunë : 4)

Pabesimtari, edhe pse nuk është fetar, vepron dhe zhvillon aktivitet të jetës për veten e tij dhe për familjen e tij. Kjo është natyrshmëri e jetës. Mirëpo cila është vlera e fesë në këtë rast?

(Përgjigjja) Vlera e fesë është se e zhvillon aktivitetin e tij dhe thotë:
Edhe pse nuk je fetar, puno:

- për veten tënde dhe

- për familjen tënde.

Dallimi në mes fetarit dhe jofetarit është në atë se fetari punon:

- për veten e tij,

- për familjen e tij dhe

- për ata të cilët nuk mund të punojnë.

Kështu, besimtari kur punon, në punën e tij nuk e ka qëllim vetëm veten e tij, mirëpo qëllimi i tij shkon edhe kah ajo që një pjesë e tij të ndahet dhe të shpenzohet edhe për Allah.

Kjo çon në atë se çështja e zekatit nga pasuria e tij është burim i ndjenjës dhe synim që në momentin e veprimit.

Kjo nuk ka mundësi të ndodhë përveçse nëse në jetë aktivizohesh për të prodhuar, dhe atë jo për të prodhuar varësisht prej shpenzimit dhe nevojave, por edhe më shumë se kaq.

Mirëpo, le të vështrojmë gjithësinë dhe të themi: Unë nuk jam i vetëm në këtë gjithësi, por ka edhe shumë njerëz tjerë, e disa prej tyre nuk mund të punojnë. Zoti i Lartmadhëruar ka krijuar jetën asisoj, e cila nuk jep garanci për të fituar aq sa ju nevojitet për furnizim, por është një kategori e njerëzve, të cilët mendojnë thellë në shpirtin e tyre, duke e ditur se vet janë të aftë të

punojnë, e në anën tjetër e shohin tjetrin i cili nuk mund të punojë, e duke e ditur se që të gjithë janë krijesa të Allahut, atëherë në këto momente u lëvizin ndjenjat e tyre. Këto ndjenja u thonë: **Paramendo sikurse unë të isha i paaftë, çka do të kisha dashur në shoqëri (bashkësi)!?**

(Përgjigjja) Do të kisha dashur që shoqëria të aktivizohej në dy çështje:

E para: Angazhim për veten dhe familjen.

E dyta: Angazhim për ata të cilët nuk mund të punojnë dhe nuk kanë aftësi të punojnë.

E falënderoj Zotin i cili më ka bërë të aftë, e ka hequr cilësinë e dobësisë në jetën time!

Pas kësaj fillon xhelozia në jetë.

Çka nënkupton xhelozia në jetë?.

(Përgjigjja) *Xhelozia në jetë është jostabiliteti. Është çështja e rotacionit në jetë.* E shoh ndonjërin, ishte i fortë, tani është i dobët. Poashtu edhe unë sot jam i shëndoshë dhe i fortë, nesër bëhem i dobët. Përderisa unë sot jam i fortë dhe nesër bëhem i dobët, në të mirën time është që t'i ndihmoj aktivitetit të të dobët. Pse?

(Përgjigjja) Ashtu që nëse pas një kohe dobësohem, i forti më ndihmon mua. Kjo është arsyeja pse Zoti i Lartmadhëruar ka caktuar rotacionin:

- Nuk e ka caktuar që njerëzit të jenë gjithmonë të aftë, dhe,

- nuk e ka caktuar që të paaftit të jenë gjithmonë të paaftë.

Zoti i Lartmadhëruar ka caktuar aftësinë dhe paaftësinë. Kjo është çështje e cila i prekë të gjitha krijesat, kështu që, përderisa njeriu i cili është i aftë e ndien se ai do të bëhet i paaftë, për të mirën e tij është që të zhvillojë dy aktivitete:

E para: Angazhimin për veten dhe familjen.

E dyta: Angazhimin për ata të cilët nuk mund të punojnë dhe nuk kanë aftësi të punojnë.

2. Afrimi me Allahun

Zoti i Lartmadhëruar i ka ligjësuar shtyllat e islamit dhe këtë ligjësim e ka bërë të vazhdueshëm në mënyrë që të shprehet pa ndalë dashuria ndaj Allahut dhe besimi në Të, ashtu që njeriun ta nxjerrë nga harresa ndaj Tij, në mënyrë që të mos i neglizhojë begatitë që i janë dhënë.

Është e vërtetë se namazi shpenzon një pjesë të kohës së jetës, por ama e bekon pjesën e kohës tjetër, ashtu që ta bën të frytshme dhe kësisoj e kompenson kohën e humbur.

Zoti i Lartmadhëruar ka dashur që të bëhet deklaram publik për dashurinë ndaj Tij. Për këtë arsye e ka ligjësuar namazin kolektiv (të xhumasë).

Ne e dimë se koha duhet të jetë në mes të dy çështjeve:

E para: Në mes të shfrytëzimit të begatisë nga e cila të përfiton energji për aktivitetin tënd në begati.

E dyta: Në mes të aktivitetit tënd në begati.

Nëse ne e vështrojmë dhe e analizojmë thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

فَإِذَا قُضِيَتِ الصَّلَاةُ فَانْتَشِرُوا فِي الْأَرْضِ وَابْتَغُوا مِنْ فَضْلِ اللَّهِ

“E, kur të kryhet namazi, atëherë shpërndajuni në tokë dhe kërkon begatitë e All-llahut.” (El-Xhumuatu : 10)

Kjo është çështja e parë.

Po ashtu Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَى ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا الْبَيْعَ

“...kur bëhet thirrja për namaz, ditën e xhumasë, ecni shpejt për aty ku përmendet All-llahu, e lini shitblerjen, kjo është më e dobishme për ju, nëse jeni që e dini.” (El-Xhumua : 9)

Kjo është çështja e dytë.

Që të dyja urdhëresat së bashku i takojnë Atij i cili e ka të drejtën e urdhrit për krijesat e Tij, e Ai është Zoti i Lartmadhëruar.

- Nëse e zbatojmë urdhrin e parë: **“Kur thirret namazi i xhumasë”** shkojmë dhe zbatojmë urdhrin për faljen e namazit dhe nuk e kemi zbatuar urdhrin tjetër, kështu që ne e kemi lënë pas dore pjesën e rëndësishme të obligueshmërisë.

Përgjatë aktivitetit të jetës nuk do të thotë se duhet të harrojmë planprogramin e Allahut

Nëse njerëzit nuk punojnë në tokë dhe nuk i shfrytëzojnë të mirat e saj, kjo do të thotë se njerëzit nuk i përmbahen planprogramit të Zotit të Lartmadhëruar.

Përderisa punohet në tokë dhe zhvillohet aktivitet, atëherë duhet të thuhet se Zoti i Lartmadhëruar e ka bërë ndërlidhjen e punës me rizkun, e cila është çështja më e rëndësishmja për njeriun. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

فَامْشُوا فِي مَنَاكِبِهَا وَكُلُوا مِن رِّزْقِهِ

“...andaj, ecni nëpër anët (me vështirësi) e saj dhe ushqehuni me furnizimin (rizkun) e Tij.” (El-Mulk : 15)

Puna në anët e ndryshme të tokës, angazhimi në rrugët e Allahut dhe lodhja, të gjitha këto të sjellin rizkun sepse vepra jote, sado që të jetë e mirë, nuk e krijon rizkun, por puna e ndërlidhë rizkun me ty, rizk i cili gjendet në tokë. Zoti i Lartmadhëruar e ka garantuar rizkun në tokë kur thotë:

قُلْ أَتُنتَكُم لَتَكْفُرُونَ بِالَّذِي خَلَقَ الْأَرْضَ فِي يَوْمَيْنِ وَتَجْعَلُونَ لَهُ أَندَادًا ۚ ذَٰلِكَ رَبُّ الْعَالَمِينَ

﴿٩﴾ وَجَعَلَ فِيهَا رَوَاسِيَ مِن فَوْقِهَا وَبَارَكَ فِيهَا وَقَدَّرَ فِيهَا أَقْوَاتَهَا

“Thuaj: - A ju jeni ata që nuk i besoni Atij që e krijoi tokën për dy ditë dhe Atij i përshkruani shok, e Ai është Zoti i botëve! Ai që në të vuri kodra të forta, ia shtoi të mirat asaj.” (Fussilet : 9,10)

Kjo i bie që furnizimet (rizku-ushqimet) janë të vendosura në tokë dhe janë të garantuara në tokë prej Zotit të Lartmadhëruar.

Vepra jote nuk e krijon rizkun (furnizimin), por puna jote të dërgon deri te rizku (furnizimi). Ky është kuptimi i ajetit kur Zoti i Lartmadhëruar thotë:

فَامْشُوا فِي مَنَاكِبِهَا وَكُلُوا مِن رِّزْقِهِ

“...andaj, ecni nëpër anët (vështirësitë) e saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij.” (El-Mulk : 15)

E shohim termin e përdorur: **“Dhe ecni”** që do të thotë **“veprim-aktivitet”**, ndërsa,

termi i përdorur: **“menakibiha”** do të thotë **“vështirësi”**.

Kjo nënkupton se puna në tokë nënkupton *veprim të mundimshëm*. Për këtë arsye, ata të cilët punojnë duhet të presin pagën e punës dhe jo atë çka ua lehtëson pagën e punës. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Jepjani pagën punëtorit para se t’i teret djersa.”**

Shumica e punëtorëve, në thënien e pejgamberit e shohin vetëm anën **“jepjani pagën punëtorit”** dhe e neglizhojnë anën tjetër të thënies **“para se t’i teret djersa”**. Kjo nënkupton se puna “e ka djersitur atë”. Çdo punë formale, e cila të zhvesh nga përgjegjësia dhe nuk të djersitë, çon në atë se ti nuk e meriton atë pagesë dhe ajo pagesë nuk është e lejuar për ty. Për këtë arsye, çdo çrregullim në këtë botë është si pasojë e punës formale dhe pa u djersitur në punë.

Punë formale do të thotë që ti ta zhveshësh veten nga përgjegjësia e cila të bie mbi supet e tua dhe të punosh pa përgjegjësi dhe me neglizhencë. Por sikur ta dije se çfarë përgjegjësie ke, atëherë nuk do të të merrte as gjumi, e atëherë do të përkujdeseshe shumë më shumë në punë, dhe do t’ua kaloje edhe tjerëve të cilët e punojnë të njëjtën punë.

Sot, kur flitet për çrregullim, për dukuri negative dhe çdo ankesë e cila paraqitet ka të bëjë për pagën e punëtorit, dhe asnjëherë nuk përmendet *djersa e punëtorit*. Kurse nëse dëshirojmë stabilitet, atëherë duhet ta përmendim të dytën mu ashtu siç e përmendim të parën. Kush mashtron, e ka mashtruar veten e tij sepse njeriu nëse ka monitorues në punë, ai është i llojit të tij, për këtë shkak çështja neglizhohet, ndërsa nëse monitoron Ai i cili është i Përgjithmonshëm, e të Cilin nuk e zë as gjumi e as dremitja, ta dish se çdo lëvizje dhe aktivitet i juaji përlllogaritet dhe nuk vonohet çështja për botën tjetër, mirëpo njeriu patjetër duhet të ballafaqohet me diçka deri sa Allahu ta sigurojë dhe ta mbrojë nga aktiviteti i jetës nga ata të cilët nuk besojnë në botën tjetër.

3. Përmendja

Aktivitet i jetës do të thotë: Udhëtimi dhe puna në sipërfaqen e tokës.

Ajo që duhet cekur në çështjen e aktivitetit është të pasurit aftësi, të pasurit mundësi. Ne e dimë se paaftësia ekziston te disa persona. Por ne shohim se paaftësia ekziston në numër të vogël dhe të kufizuar. Nëse përlllogarisim dhe analizojmë numrin e personave me aftësi të kufizuar, si f.v., kaq janë të çmendur, kaq janë pa një këmbë, kaq janë të verbër, rezulton se përballë shumicës (personave të aftë) janë pakicë (personat me aftësi të kufizuar).

Zoti i Lartmadhëruar, këtë pakicë e ka paraparë në botë që njerëzit t'i shikojnë (përkujtojnë) begatitë e Allahut në veten e tyre, nëse veç kanë harruar.

- Ti nuk e di begatinë e syve të tu përderisa nuk e sheh të verbrin teksa mundohet. Kur e sheh atë, atëherë zgjohesh dhe e shikon veten tënde.

- Ti nuk e di vlerën e ecjes tënde (këmbëve tua) përderisa nuk e sheh të çalin.

- Ti nuk mund ta dish vlerën e organeve në trupin tënd të cilat veprojnë në bazë të dëshirave tua, përderisa nuk e sheh një njeri i cili nuk mund të lëvizë organet e trupit të tij në bazë të dëshirave të tij. E sheh se dëshiron të lëvizë, por nuk mundet sepse nuk funksionon nervi i cili e dirigjon atë organ të organizmit.

Në përmendje të atyre të cilët janë me aftësi të kufizuar kemi sqarim për ata të cilët i harrojnë të mirat

Aftësinë e kufizuar në krijesat e Allahut, Allahu e ka bërë mjet që krijesat e Allahut ta kuptojnë se i kanë harruar të mirat e Tij. Për këtë arsye, njerëzit me aftësi të kufizuar janë të paktë (pakicë). Mirëpo, paraqiten pyetjet:

Pse Allahu i ka zgjedhur personat me aftësi të kufizuar që të jenë shembull për ne?

Cili është mëkati i tyre?

Cili është mëkati i të verbrit që Allahu e ka bërë të jetë i verbër?

(Përgjigjja) Ti e sheh çka i mungon (i është marrë) atij, mirëpo ti nuk e di se çka Allahu i ka dhënë atij në kundërvlerë të asaj aftësie të kufizuar.

Nëse ti shikon në dukurinë e aftësisë dhe analizon me vëmendje çdo begati, do të shohësh se atij i është dhënë aftësi tjetër e cila ia kompenson të munguarën. Poeti thotë:

Është verbëruar i mençuri

edhe pse mençuria e tij është nga verbëria.

Dhe humbi drita e syrit kur zemra refuzoi diturinë.

Atëherë kur njerëzit e humbin virtytin e zemrës.

Shprehje të cilën Zoti i Lartmadhëruar e vendos në logjikën e paaftësisë së tyre logjiku. Ata e marrin formën e formës së paaftësisë nga mjetet ekzistuese. Ata mund të jenë burim i aftësisë në çështje tjera sepse kur e sheh se atij i mungon diçka nga njerëzit tjerë, ai provon që në veten e tij të gjejë diçka çka e zhvillon dhe këtë e bën deri sa ta zëvendësojë atë çka i mungon. Shumë prej gjenive kanë qenë me aftësi të kufizuara.

Kështu pra, Zoti i Lartmadhëruar kur dikujt i merr diçka, atë ia kompenson me diçka tjetër. Zoti i Lartmadhëruar nuk ka marrë fëmijë për veten e Tij. Përderisa ai nuk ka marrë fëmijë për veten e Tij, atëherë të gjitha krijesat në këtë pikë janë të njëjtë me Zotin. Në përgjithësi janë të barabartë. Për këtë arsye në të kaluarën thoshim:

Përlllogaritja kryesore është kur njeriu i llogarit çështjet si në vijim:

- të jetë i shëndoshë,
- të mos ketë të meta në trup,
- të jetë i lumtur,
- të jetojë i qetë,
- të jetë me mendje të shëndoshë, i mençur,
- të ketë mundësi të ketë fëmijë,
- të ketë mundësi të punojë dhe të sigurojë ekzistencën,
- të ketë edhe këtë... pastaj...

Kur të mblidhen të gjitha këto, do ta shohësh se në përgjithësi të gjithë njerëzit janë të barabartë në këto çështje, mirëpo ajo e cila i peshon të gjitha këto çështje është **devotshmëria**.

Mirëpo njerëzit kur i shikojnë dallimet, i shikojnë dallimet në trup dhe i harrojnë specifikat e tjetrit. E sheh veten të pastër dhe me dukje të mirë dhe sheh te tjetri ndryshe. Po të ishte i logjikshëm, i mençur dhe besimtar, do të duhej të thoshte: Cila është çështja e cila e bën dallimin në mes atij i cili është më poshtë se unë në veshje dhe dukje, që t'ia kompensoj atë që kam unë me mjete materiale. Mos e nënçmo pse ka mangësi në diçka. Nënçmoje veten në atë që ti ke mungesë në diçka çka ai e ka, e ti nuk e ke. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë:

لَا يَسْخَرُ قَوْمٌ مِّنْ قَوْمٍ عَسَىٰ أَن يَكُونُوا خَيْرًا مِّنْهُمْ

“Nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër.” (El-Huxhuratë : 11)

Pse kjo kështu?

(Përgjigjja) Sepse ti shikon vetëm çështjen sipërfaqësore dhe nuk shikon edhe çështjet të cilat të janë dhënë ty. Mos ashtu! Shikoje edhe atë, shikoje në thellësi, çka posedon ai. Mblidhi begatitë dhe do të shohësh se ai ka disa gjëra më të mira se ti. Secili merr të drejtën e tij nga kandari.

Dallimi mes njerëzve tregon dobinë prej njëri-tjetrit

Parashtrohet pyetja: Pasi çështja është kështu, çka ka përfituar i çmenduri nga kjo botë?

(Përgjigjja) Të çmendurin Zoti e ka krijuar njeri. Siç e dimë, njeriu është i dalluar me logjikën e tij. I çmenduri, në aspektin logjik është në pozicion negativ, pasi që i është hequr specifika e logjikës.

Çështja është kështu:

Çka dëshirojnë të mençurit e shëndoshë nga organet e tyre të shëndosha?

Çka dëshirojnë të mençurit në këtë jetë?

(Përgjigjja) Dëshirojnë që kur të thonë diçka të mos u refuzohet. Dëshirojnë të mos qortohen dhe të mos mallkohen për asgjë.

Në esencë kjo veç i është dhënë të çmendurit. Sepse i çmenduri ndonjëherë rrëzohet dhe ai qeshë. Nuk pyet për veprimin të cilin e vepron nga shkak se edhe Zoti i Lartmadhëruar nuk e pyet për veprimet e tij në ditën e gjykimit.

Qëllimin, të cilin dëshiron që të angazhohet dhe ta realizojë personi, veç e ka arritur ai person të cilin e quajmë të çmendur. Veprimet e tij në jetë janë të zakonshme, pa brenga. Pra, kështu e ka caktuar Allahu. Me ato veprime, apo me një veprim prej veprimeve të tij, ta tejkalon ty, edhe pse e ke mendjen e shëndoshë, dhe ta tejkalon me veprimet e tij gjatë gjithë jetës. Si ndodhë kjo?

Njeriu (i mençur nga ne), i di të vërtetat dhe realitetin, por mendja e fsheh dhe nuk e tregon me fjalë, ndërsa i çmenduri e thotë fjalën e vërtetë dhe nuk brengoset, ndërsa ti nuk do ta tregoje. Për këtë arsye mendja quhet “mendje”. Pse?

(Përgjigjja) Logjikë do të thotë: atë të cilën e logjikon me logjikën tënde dhe të bën të mos e veprosh, e te i çmenduri është e kundërta, ai e bën dhe nuk brengoset. Ai ndonjëherë ecë dhe nuk rrëzohet, në momente kur të tjerët në raste të ngjashme rrëzohen, njerëzit okularë qeshin me të, e edhe polici qesh me të.

Kështu pra, i çmenduri, në një moment prej momenteve të veprimit me çmendurinë e tij, vepron çka ti me logjikën tënde nuk mund të veprosh asnjëherë në jetën tënde.

Zoti i Lartmadhëruar kur ka përcaktuar furnizimet, ka përcaktuar të gjitha mënyrat e jetesës për krijesat e Tij. Ta dini se, furnizimet janë të barabarta dhe jo të njëjta, jo të përsëritshme (uniforme).

“E njëjtë e përsëritshme” nënkupton atë që ti ke këto cilësi të mira dhe unë i kam të njëjtat. Mirëpo, Zoti i Lartmadhëruar dëshiron që ekzistencën ta ndërlidhë ashtu që njëri me tjetrin të ndërlidhen me ndërlidhje të dobishme e të ndërsjellë. Ti ke nevojë për mua, unë kam nevojë për ty. Kjo nuk mund të realizohet ndryshe përpos nëse dallohem me veçori ndaj njëri-tjetrit.

Njeriu i cili i posedon disa veçori, një pjesë ua jep atyre që nuk i posedojnë (ato veçori). Në këtë mënyrë respektohet dhe nuk kundërshtohet caktimi i Allahut.

Me këtë nënkuptohet që secili prej neve duhet ta respektojë Allahun për atë që ia ka dhënë në posedim dhe nëse secili prej nesh e respekton Allahun për atë që ia ka dhënë në posedim, atëherë caktimi i Allahut në ato çështje është i dobishëm.

Në të kaluarën thoshin: **Kush ia jep të verbrit të drejtën, ai është me sy (sheh).**

4. Namazi, shoqëria dhe forca në islam

Pejgamberi s.a.v.s. në namaz është përqendruar në dy çështje:

E para: Çështja e cila kërkon qetësimin e gjendjes - ajo është për të përjetuar begatitë dhe për të falënderuar. Për këtë arsye pejgamberi s.a.v.s. qetësohej dhe freskohej në namaz.

E dyta: Brenga - përkujtimin e vazhdueshëm në Zotin e Fuqishëm dhe të Gjithëpushtetshëm e bënte ashtu që nëse një çështje nuk i shkonte si duhej, falte namaz.

Kështu pra, namazi e ka etikën dhe estetikën ku qetësohet shpirti, në të shihet madhështia, të cilës i nënshtrohet i fuqishmi. Përderisa të gjitha obligimet të cilat i ka obliguar Allahu për robërit e tij janë që i obliguari të jetojë duke i kryer ato obligime, atëherë vetëm namazi bën që i obliguari të jetojë me Obliguesin dhe kur i obliguari jeton me Obliguesin dhe në prezencën e Tij ekziston forca e rrezatimit dhe paraqitjes së dritës, dritë rrezatuese e cila paraqitet në të gjitha obligimet në jetë, me anë të të cilave fitohet ndihmë dhe mbështetje nga Allahu dhe kjo dritë forcohet nga Zoti i Cili i ka krijuar të gjithë njerëzit.

Ne, të gjitha obligimet i kemi prej Allahut, mirëpo në namaz jemi me Allahun. Të gjitha obligimet janë si rezultat i cilësive të Tij, ndërsa namazi është rezultat i Tij. Për këtë arsye, namazi e ka pasur fatin që prej të gjitha obligimeve ta ketë vendin e posaçëm të obligimeve sepse të gjitha obligimet tjera janë obliguar nëpërmjet Xhibrilit, kurse vetëm namazi është veçuar me atë se Muhamedit a.s. i është komunikuar prej Zotit të Lartmadhëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Është specifikuar edhe me atë se është shtyllë e islamit dhe shtyllë e muslimanit. Dallimi në mes të shtyllës së islamit dhe shtyllës së muslimanit qëndron në atë se, siç e dimë shtyllat e islamit janë pesë, mirëpo sa i përket të obliguarve në islam, e shohim se në disa raste ndodhë që disa shtylla të islamit bien nga obligimi, kështu që shtyllë e muslimanit është ajo që mbetet pasi të bien shtyllat tjera, varësisht se cila shtyllë prej shtyllave mungon në obligueshmëri.

Namazi dhe shtyllat e islamit

Muslimani i cili nuk mund të shkojë në haxh, e dihet se islami i ka pesë shtylla (e haxhi një ndër to), atëherë muslimani në këtë rast mund t'i realizojë vetëm katër shtyllat tjera.

Nëse ai nuk mund ta kryej haxhin dhe nuk mund të agjërojë për shkak të ndonjë sëmundje të përkohshme, nga ai bie obligueshmëria e agjërit dhe i mjafton fidja. Kështu pra, në këtë rast, për persona të tillë llogariten tri shtylla.

Për të varfrin, pra sa i përket muslimanit të varfër, shikohen dy çështje:

E para: Dëshmia se nuk ka Zot tjetër pos Allahut dhe se Muhamedi a.s. është i dërguar i Allahut.

E dyta: Falja e namazit.

Namazi është shtyllë themelore e pandashme për besimtarin. Nuk ndahet prej tij në asnjë çast dhe nuk arsyetohet në asnjë rrethanë prej rrethanave të krijuara në jetë.

Falësi i cili nuk mund të falet në këmbë, falet ulur.

Nëse nuk mund të falet ulur, falet i shtrirë.

Nëse nuk mund të falet i shtrirë, falet me shenja.

Nëse nuk mund të falet me shenja, atëherë falet siç ka mundësi, pra vetëm me mendje, duke e menduar faljen e namazit, kështu që ai i përmbledh kushtet e namazit në mendjen e tij dhe falet vetëm me mendjen e tij.

Kështu pra, namazi është çështje e pandashme prej së cilës besimtari nuk mund të lirohet asnjëherë.

Kështu pra, namazi është shtyllë e islamit dhe shtyllë e secilit musliman. Për këtë arsye edhe obligueshmëria e tij (ligjësimi i namazit) ka ndodhur në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndërsa obligueshmëria e drejtpërdrejtë drejtuar të dërguarit të Allahut s.a.v.s. na e përkujton afrimin e tij me Allahun në Sidretul Munteha se si është përshëndetur Muhamedi a.s. me afërsi dhe si atë përshëndetje e ka përcjellë te umeti i tij me mjetin prej mjeteve afruese.

Njeriu më së afërmi është me Zotin e tij atëherë kur është në sexhde.

Namazi në vete përmban kohën dhe vendin. Çdo vepër të cilën e vepron njeriu, përbëhet prej vendit dhe kohës, vetëm se tek obligimet:

- ndonjëherë veprimi i obligimit përmban kohë dhe nuk përmban vend;

- ndonjëherë veprimi i obligimit përmban vend dhe nuk përmban kohë;
- ndonjëherë veprimi përmban edhe kohë edhe vend, pra i përfshinë të gjitha elementet e ngjarjes dhe veprimit.

Në shtëpitë e Allahut

Namazi shpenzon kohë. Falësi është i lirë të falet në çdo vend sepse Zoti i Lartmadhëruar ia ka specifikuar Muhamedit s.a.v.s. ashtu që e ka bërë të gjithë tokën xhami dhe të pastër. Ti mund të falesh në çdo vend. Kështu pra, obligueshmëria është e përkufizuar me fjalë, veprim dhe aktivitet në kohë, ndërsa është e lirë dhe e pakufizuar me vend. Këtu kemi një element prej elementeve të obligueshmërisë së personit i cili është i lirë, mund të falet në çdo vend, mirëpo vendi në të cilin falet është tokë, xhami dhe i pastër.

Vendet në të cilin lejohet falja e namazit gjatë gjithë jetës janë:

- fabrika, ku ti e organizon jetën tënde,
- fusha, ku ti e organizon jetën në bujqësi, me pemë e perime,
- shkolla (universiteti), ku ti përfiton dituri.

Kështu pra, vendi ku lejohet falja është i gjerë dhe i gjatë, aty ku lejohen përpos faljes së namazit të gjitha çështjet e jetës.

Pas kësaj, nëse dëshirojmë që të largohemi nga ndonjë vend dhe themi këtë vend nuk e shfrytëzojmë për nevojat e jetës asnjëherë, por e veçojmë vetëm për namaz, atëherë e quajmë **mesxhid** dhe nuk e quajmë **“bejtullah”**.

Kur të jesh në **mesxhid**, atëherë është koha për t’u takuar me Zotin tënd dhe nuk lejohet të angazhohesh me diçka tjetër. Të mjafton që prej 24 orëve në ditë, 1 orë ta ndash për Zotin tënd dhe të shkëputesh nga aktiviteti i jetës.

Mesxhidi është vend i përcaktuar si vend ku lejohet falja e namazit. Vendi si vend, është vendi të cilin e zgjedhin njerëzit, ashtu që populli thotë: Shtëpinë e Zotit do ta ndërtojmë në këtë vend. E quajmë shtëpi të Allahut, por me zgjedhjen e krijesave të Allahut. Për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar drejtimin për namaz e ka bërë të gjerë dhe të gjatë në tërë rruzullin tokësor ose në vendin e caktuar për namaz dhe për takimin me Allahun. E ka bërë që orientimi për në shtëpinë e Allahut të bëhet nga të gjitha anët, por me zgjedhjen e Allahut.

Shtëpia e Allahut është në Meken fisnike, ndërsa shtëpia e Zotit tonë dhe shtëpitë e Allahut mund të jenë në gjithë tokën.

Vendi i Shtëpive të Allahut zgjidhet prej krijesave të Allahut.

Është e patjetërsueshme që shtëpitë e Allahut, të zgjedhura prej krijesave të Allahut të pasojnë shtëpinë e Allahut e cila është zgjedhur prej Allahut.

Nëse analizojmë zekatin, zekati merr një pjesë të kohës së aktivitetit të jetës, pra prej pasurisë, por nuk ta përcakton kohën në mënyrë strikte, por jepet në ditën e korrjes së të lashtave dhe jepet brenda vitit, kur ke pasuri. Pas kësaj, sa i përket vendit, ti je i lirë që ta transferosh zekatin në ndonjë vend tjetër ku ka nevojtarë dhe të varfër.

Në Iëtikaf, kur përcaktohet veprimi i tij, përcaktohet vendi dhe nuk përcaktohet koha.

Obligueshmëria shkakton shpenzim të aktivitetit, pra veprimin, i cili veprim harxhon kohë ose harxhon energji të veprimit e cila bëhet gjatë veprimit, i cili veprim zë vend, pas kësaj i obliguari kalon në ndonjë vend tjetër.

Haxhi është shtylla e vetme në të cilën është e përcaktuar:

- vendi,
- koha dhe
- veprimi:

Sa i përket kohës, është i përcaktuar në muaj preciz.

Sa i përket vendit është e specifikuar në shtëpinë e Allahut (në Qabe).

Për këtë arsye themi se në këtë çështje është i përcaktuar veprimi, koha dhe vendi, dhe shpërblimi i haxhit për njeriun është që kur e përfundon haxhin e pranuar del prej mëkateve sikurse në ditën kur ka lindur prej nënës së tij.

Namazi është takimi me Allahun

Nëse e analizojmë namazin nga një këndvështrim tjetër, shohim se namazi ndikon që të takohesh me obliguesin, e ai është Zoti i Lartmadhëruar, të Cilin ti nuk e sheh. Po ashtu edhe furnizimet që vijnë prej Tij, janë asisoj çfarë ti nuk i sheh. Çka nënkuptojmë me këtë?

(Përgjigjja) Me këtë nënkuptojmë se kur thirret për ty ezani, në një kohë prej kohëve të namazit, ti shpejton për të falur namazin, për të iu përgjigjur thirrjes së tij. Kur një njeri e thërret një njeri në shtëpinë e tij, çka i përgatitë? A i paraqet më të mirën të cilën e posedon? Po nëse thirrësi është Zoti yt, e të mirat e Tij janë të pakufishme, e përsosmëria e Tij është e pakufizuar, atëherë çka mendoni, me çka ju përshëndetë?

Ai do të të përshëndetë me përshëndetje. Do të të përshëndetë me atë çka posedon sepse Ai të ka thirrur ty në shtëpinë e Tij. E përshëndetja e Tij është e panjohur për ty.

Zoti i Lartmadhëruar, i Vërteti, i Cili të sjellë furnizimin ty andej nga nuk e sheh.

Përshëndetja e Tij është begatia e cila buron dhe shkëlqen.

Begati në të gjitha anët dhe në të gjitha aspektet.

Zemrën tënde e mbush qetësi.

Shpirtin tënd e mbush kënaqësi.

Trupin tënd e qetëson.

Atëherë ti me veprimin tënd ke arritur te Prodhuesi, e Ai është i drejti. Dhe ti prodhimtarinë tënde e paraqet te Prodhuesi pesë herë në ditë që të mos ndjesh lodhje asnjëherë.

Nëse e analizojmë nga një këndvështrim tjetër, siç kemi thënë, e shohim se është shtyllë e muslimanit, e cila plotësohet me namazin, nga shkaku se njeriu e ka për obligim që gjatë gjithë jetës vetëm një herë të deklarojë dëshminë e shehadeetit: **“Nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe Muhamedi është i dërguar i Allahut.”**

Mirëpo, në namaz e përsëritë deklaratën, pra e përsëritë shehadeitin. Kështu pra, në namaz e përsëritë shtyllën e parë, **SHEHADETIN**.

Pas kësaj e kemi shtyllën e tretë, e cila është **ZEKATI**.

Zekati është të ndash një pjesë të pasurisë tënde dhe të japësh për kategoritë e njerëzve të cilat i ka përcaktuar Allahu si falënderim ndaj

Allahut i cili të ka ngritur në aso pozite ku ti duhet të japësh pasuri dhe nuk të ka vendosur në pozitë për të marrë pasuri (prej tjerëve).

Nëse namazi është dhënie prej kohës, kurse pasuria është si rezultat i punës, puna është si rezultat i shpenzimit të kohës, mirëpo në namaz ke një pjesë të kohës dhe e ke përcaktuar për Zotin tënd dhe sikurse jepet një pjesë e pasurisë së zekatit për të pasur begati më të madhe, pastrim dhe shtim të pasurisë, njësoj edhe kohën të cilën e ke ndarë prej jetës tënde (për namaz) është pastrim dhe shtim në pasuri dhe begati. Kështu pra, në namaz është zekati i bazës së pasurisë.

Po ashtu në namaz paraqitet shtylla e **AGJËRIMIT**.

Agjërimi është abstenim i ushqimit dhe epshit gjatë ditës së Ramazanit. Edhe namazi të ndërprejnë nga ushqimi dhe epshi. Namazi ta ndërprejnë atë që është e lejuar për të në agjërim sepse në namaz nuk ke të drejtë të flasësh dhe të ecësh edhe pse në agjërim ke të drejtë të ecësh dhe të flasësh sepse agjërimi është më i përgjithshëm.

Po ashtu në namaz e kemi edhe shtyllën e **HAXHIT**.

Në çdo kohë të namazit orientohesh te Zoti yt dhe e orienton fytyrën në drejtim të shtëpisë së Allahut, në Qabe. Atë e ke gjithmonë prezent. Kjo i bie që në namazin, i cili si obligim asnjëherë nuk bie nga obligimi, në të janë përmbledhur të gjitha shtyllat e islamit:

- **Dëshmia se nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Allahut.**

- **Falja e namazit.**

- **Dhënia e zekatit sepse është dhënie e zekatit të kohës, nga e cila fitohet pasuria.**

- **Agjërimi i ramazanit sepse të bën të agjërosh sikurse në agjërim.**

- **Kryerjen e haxhit.**

Namazi është bërë obligim në mënyrë të drejtpërdrejtë

Pasi që namazi e ka këtë rëndësi atëherë patjetër se duhet të dallohet nga të gjitha obligimet tjera.

Obligimet tjera janë obliguar me ndërmjetësim, pra me shpallje. Mirëpo namazi është obliguar pa ndërmjetësim, pra në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Zoti i Lartmadhëruar te i dërguari i Allahut Muhamedi s.a.v.s.

Kështu pra, duhet të ketë rëndësinë e ligjësimit ose mjetin e veçantë të ligjësimit duke pasur parasysh se veprat janë mjete te i ngarkuari. Namazi është prezent me të ngarkuarin. Për këtë arsye, e shohim këtë rëndësi të veçantë. Kësaj dukurie të veçantë, ndoshta nuk mund t'i ikë askush, pos atyre të cilët e gjejnë mundësinë që shpirtrat e tyre t'i qetësojnë me Allahun, ashtu që nuk i shkon mendja askund përpos te Zoti i Lartmadhëruar. Ti kur të jesh në gjendje të vështirë të jetës nuk mund të gjesh vend ku mund ta freskosh mendjen pos në falje të namazit. Ndonjëherë gjatë namazit, njeriut i forcohet memoria, për shkak të qëndrimit të tij para Zotit të tij. Po ta kuptonim këtë, do ta kuptonim thënien e Zotit të Lartmadhëruar kur na e paraqet polemikën e Iblisit me Zotin kur thotë:

قَالَ فَبِعِزَّتِكَ لَأُغَوِّيَهُمْ أَجْمَعِينَ ﴿٨٢﴾ إِلَّا عِبَادَكَ مِنْهُمْ الْمُخْلَصِينَ

“Dhe me fuqinë Tënde do t'i mashtrojë të gjithë robërit e tu të singertë.” (Sad: 82, 83)

Po ashtu Iblisi ka thënë:

لَأَفْعُدَنَّ لَهُمْ صِرَاطَكَ الْمُسْتَقِيمَ

“Unë do t'u ulem atyre (do t'u zë pusi) në rrugën Tënde të drejtë...” (El-Earafë: 16)

Kur dëshiron shejtani të mashtrojë, nuk shkon në restaurant apo në vendet e mëkatimit. Pse?

Nga shkakun se ata të cilët shkojnë në ato ambiente, e kanë ndarë mendjen dhe nuk ka më vend për vesvese (të shejtanit).

Kështu pra, shejtani orientohet në vendin më të mirë dhe në vendin më të afërt me Allahun dhe nga shkakun se namazi e ka këtë rëndësi të posaçme, mundohet t'ia prish namazin njeriut.

Po ashtu edhe njeriu i ndihmon shejtanit sepse shejtani ia tërheq mendjen në thelbin e çështjes, pastaj e merr mendjen e namazliut dhe e

vendos në piedestalin e çështjes dhe i shkon rreth e rrotull mendimeve. Njeriu do të duhej që nga momenti kur e cyt shejtani në mendjen e tij të thotë siç e ka mësuar Zoti i tij:

وَأَمَّا يَنْزَغَنَّكَ مِنَ الشَّيْطَانِ نَزْغٌ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ ۖ إِنَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٢٠٠﴾

“Nëse shejtani tenton të të shtyjë drejt së keqes, kërko strehim tek Allahu, se vërtet, Ai dëgjon dhe di gjithçka.” (El-Earafë: 200)

Mirëpo, ne lëre që nuk kërkojmë mbrojtje, por përkundrazi, e marrim shejtanin për litari dhe e bëjmë të qarkullon në mendjet dhe logjikën tonë.

Shejtani e prishë namazin e muslimanit

Nëse veç ndodhë dhe që nga fillimi shejtani e kupton se ti e di se të është afruar dhe shejtani e kupton se ti e ke kuptuar se ai ka ardhur që t'i prishë raportet tua dhe qëndrimin tënd me Zotin tënd. Dhe përderisa shejtani ndërhyjnë te njeriu, ndërhyjnë në qarkullimin e gjakut, kush është ai i cili depërton aty për ta larguar shejtanin?

(Përgjigjja) Zoti i Lartmadhëruar është Krijuesi ynë. Duhet të kërkoj ndihmë, mbrojtje dhe përkrahje nga Allahu për cytjet e shejtanit. Dhe që nga momenti kur ke kërkuar mbrojtje dhe e ke lënë mendjen të qetë, që nga ai moment nuk ndodh asgjë tjetër përpos dy çështjeve:

E para: Ai është në prezencën e Zotit të tij dhe ideja të cilën e ka plasuar shejtani është për çështje të kësaj bote. Atëherë krahaso çështjet e botës tënde dhe qëndrimin tënd para Zotit tënd. Është e pamundur që besimtari t'i jep përparësi çështjeve të tij të kësaj bote duke qëndruar para Zotit të Tij. Kur shejtani e kupton këtë, kalon në çështje tjetër.

Kështu pra, kur shejtani ka thënë: **“Do të ulem pranë tyre, në rrugën Tënde të drejtë...”** e ka ditur fushveprimtarinë e tij, e ka ditur pozitën e tij, por Allahu është Ai i cili e ka krijuar atë dhe na ka përgatitur se si mund ta largojmë atë sëmundje.

Çështja e dytë: Shejtani është sikur hajdut. Hajduti asnjëherë nuk shkon te shtëpia e prishur, por gjithnjë shkon te shtëpia luksoze dhe e mirë. Dhe kur pronari i shtëpisë së mirë ulet pranë dritares dhe e sheh hajdutin dhe anohet nga dritarja, që nënkupton se e ka kuptuar se ai gjendet në shtëpi dhe e kupton se e ka parë ai, atëherë çfarë qëndrimi merr hajduti?

Atëherë hajduti ik dhe largohet nga shtëpia e mirë.

Në lidhje me këtë çështje e kemi tregimin e bukur nga Ebu Hanifeja i cili tregim vërteton realitetin dhe thënien e Iblisit: **“Do t'u qëndroj atyre në rrugën Tënde të drejtë.”** Ebu Hanifeja ka qenë i njohur për devotshmëri dhe për dhënie përgjigje për çështje të ndërlikuara. Zoti i Lartmadhëruar i kishte dhënë atij mençuri me të cilën i zgjidhte problemet. Njerëzit e kishin kuptuar këtë. Dhe kush kishte ndonjë problem shkonte te Ebu Hanife dhe kërkonte përgjigje edhe për çështje të cilat nuk kishin ndërlidhje me ligjësim apo me njohuri shkencore. Njëherë një njeri shkon te Ebu Hanife dhe i thotë: O imam, unë e kam groposur një vend dhe e kam fshehur pasurinë time duke e mbuluar gropën. Pasi kaloi një kohë, unë e kam harruar vendin ku kam groposur pasi që është mbuluar me dhe. Ku është ai vend o imam?

Ebu Hanife i thotë: Kjo nuk është çështje për përgjigje, kjo nuk ka të bëjë me çështje të fikhut, por po të jap një sugjerim, shko dhe fale jacinë dhe pasi ta falësh jacinë, vazhdo fal namaz nate dhe eja në mëngjes të shohim se çka do të ndodhë.

Përderisa imami ishte duke e falur sabahun dhe posa e përfundoi namazin, njeriu i del përpara dhe i thotë: O imam, të përgëzoj, se me të vërtetë e gjeta pasurinë. Imami i thotë: Si e gjete? Njeriu i thotë: Siç më the, isha duke qëndruar në namaz dhe në mes të namazit m'u hap dritarja e mendjes dhe mendja më tha: A nuk e di se si e ke matur vendin me hapa. Mate distancën me hapa në drejtim të jugut. Mate distancën me hapa në drejtim të lindjes dhe kështu arrin te vendi i fshehjes së pasurisë. E ndërpreva namazin dhe shkova te vendi i pasurisë. Ebu Hanife i thotë: Për Zotin shejtani e ka ditur dhe nuk ka dashur të qëndrosh me Zotin tënd gjatë gjithë natës. Po a nuk e vazhdove namazin për të falënderuar Zotin? Njeriu i tha: Në dashtë Zoti do ta vazhdoj.

Kështu pra, namazi ka rëndësi të posaçme në çështje të fesë dhe është në harmoni për të gjitha mënyrat e jetës.

5. Namazi dhe edukata

Bazament i jetës së njeriut është edukata. Esenciale në jetë është që njeriu të jetojë i organizuar, të ketë rregull dhe jo të jetojë në kaos.

Me organizimin e jetës njeriu përfiton shumë kohë.

Namazi është zbatimi praktik i rregullit dhe edukatës në jetë.

Simbol i namazit është fjala **“Allahu ekber”**, e cila është kohë e adhurimit, e cila e merr kohën e çdo veprimi të cilin e veprojmë. Ajo është kohë të cilën duhet ruajtur dhe kohën të cilën e ruajmë në të gjitha veprat tona, atëherë kemi mundësi të aftësohemi në organizimin e kohës.

Po ashtu, njerëzit jashtë shtetësisë së Allahut edhe nëse falen në vendet e tyre të përgjithshme, pra në përgjithësi në xhaminë tokë, dallojnë gjendjet e tyre dhe aftësitë e tyre.

Njëri falet në shtëpinë e tij, tjetri falet në fabrikë, mirëpo kur shkon në shtëpinë e Allahut, zhvishet nga çdo çështje e cila ka vlerë jashtë xhamisë dhe të gjithë njerëzit nivelohen dhe janë të barabartë. Atë të cilin jashtë xhamisë e sheh me reputacion dhe të ngritur, atë i cili ka pozitë të lartë, ulet në xhami deri sa të përfundon tubimi dhe ulet pranë njeriut i cili nuk është në pozitën e tij.

Këtu e kuptojmë adhurimin e vërtetë, të barazuarit e të gjitha krijesave të cilat i ka krijuar Allahu e të cilat tek Allahu nuk kanë dallim.

Këtu (në xhami) para Zotit të Lartmadhëruar, kur i dobëti e sheh të fortin të nënshtruar dhe duke i bërë Allahut sexhde në tokë, e kupton se adhurimi ndaj Allahut është më i lartë se qeverisja në tokë dhe ky njeri, te i cili frikohem të shkoj është i barabartë me mua dhe e ka vendosur ballin poshtë. Kjo është çështja më e ndershme për Allahun, sunduesin absolut, kjo është sa i përket të dobëtut kur e sheh të fortin.

Përderisa, sa i përket të fortit kur e sheh të dobëtin, dhe ai e sheh këtë, pra se i dobëti është i barabartë me të në adhurim. Edhe ai duhet të mos tregohet i lartë jashtë xhamisë sepse ai e sheh qëndrimin e tij të përulur, e sheh qëndrimin e tij në rukuë, e sheh qëndrimin e tij në sexhde. Ka rënë në pozitën e të dobëtut dhe është thyer prestigji i lartësisë së tij apo i pasurisë së tij apo inferioriteti i të fortit.

Kështu pra, ky veprim vjen nga niveli i të lartit te niveli i të poshtmit dhe po ashtu nga niveli i të ulëtut te niveli i të lartit, dhe njerëzit hyjnë në

sferën e adhurimit. Kuptimi i sferës së adhurimit është se bashkohemi në një pikë, e ajo është: **“Adhurimi absolut ndaj Allahut.”**

Namazi dhe urdhri janë Një

Zoti i Lartmadhëruar me anë të namazit na mëson se si duhet të veprojmë të gjithë së bashku duke iu nënshtruar një urdhri, e ai është Imami. Njeriu (në namaz) flet dhe vepron pasi të flet dhe të veprojë Imami, pra ata e pasojnë Imamin. Pse?

(Përgjigjja) Sepse aktiviteti në jetë patjetër duhet ta ketë udhëheqësin dhe njerëzit paraqiten për të marrë përgjegjësi. Në këtë rast, atë i cili merr përgjegjësi (Udhëheqjen-Qeverisjen) nuk duhet ta shikojmë si nder për të, por duhet ta dimë se ai është i ngarkuar (me përgjegjësi).

Emërimi në poste nuk është nder, por është përgjegjësi. Kjo për atë i cili e kupton të drejtën e përgjegjësisë.

Nëse bëhemi të dëgjueshëm dhe asnjëri nga ne nuk e kundërshton udhëheqësin tonë dhe nëse ky koncept vulozet në zemrat tona, nëse këtë çështje e bëjmë përditshmëri, atëherë do të bëhet e zakonshme (e përditshme) që të dëgjojmë urdhrat dhe të mos i veprojmë ndalesat dhe aktiviteti ynë do të ishte në harmoni me njëri-tjetrin ashtu që energjitë bashkohen dhe nuk shkapërderdhen, ndërlidhen dhe nuk shpërpushen.

Ekziston edhe një çështje tjetër, nëse Imami bën ndonjë veprim i cili është në kundërshtim me namazin, atëherë cilido prej pasuesve të Imamit që ka mundësi duhet ta rregullojë gabimin e tij, nëse Imami harron i tërhiqet vërejtja, nëse gabon i tregohet për ta përmirësuar gabimin.

Nuk ka tregues më të mirë se sa rasti kur prezantuesi pranë të dërguarit të Allahut e pyet të dërguarin e Allahut: A mos e shkurtove namazin apo mos ke harruar?

I dërguari i Allahut i thotë: Asnjëra prej tyre nuk ishte!

Atëherë prezantuesi i thotë: Por diçka prej tyre kishte.

Nga kjo ngjarje shihet se njëri prej sehaveve e ka kundërshtuar të dërguarin e Allahut. Pse?

(Përgjigjja) Kjo situatë (ngjarje) është përgjegjësi prej Allahut. Muhamedi a.s. dhe urdhëresa për të janë adhurim ndaj Allahut.

Në këtë mënyrë, me anë të namazit përfitojmë mësim nga udhëheqësi ynë, e ajo është se ne kemi zbatuar thirrjen prej Allahut dhe jemi prezent para Allahut, po ashtu kemi ardhur në pozitën për të kuptuar

- krijimin,

- sistemin dhe
- politikën.

Nëse këtë e praktikojmë vazhdimisht, çka do t'ishte statusi?

Statusi do të ishte se muslimanët arrijnë në pozitën në të cilën dëshiron Allahu, robër fisnik, (status) sikurse të melekëve, dhe po të mos ndërhynte shejtani në adhurim dhe po të mos sillej në zemrat e robërve, njeriu do të ngrihej lart krijesave aq sa do t'i shihnin hapësirat e qiejve dhe të tokës.

Namazi është për të nderuar njerëzimin

Kur Zoti i Lartmadhëruar na ka obliguar me namaz, na ka obliguar për të na nderuar sepse na ka ftuar për të na dhuruar, e përderisa të fton për dhuratë, nuk është e drejtë refuzimi i ftesës.

Zoti i Lartmadhëruar na ka ftuar pesë herë përgjatë ditës dhe natës. Përpos kësaj nuk e ka mbyllur derën në kohët tjera, por në pesë kohë e ka bërë të domosdoshme që t'i përgjigjemi ftesës, e ka bërë të domosdoshme që në ato pesë kohë të prezantojmë për t'i marrë begatitë (dhuratat) e Allahut.

Zoti i Lartmadhëruar të ka obliguar të prezantosh që t'i marrësh begatitë (dhuratat) dhe të pranosh përshëndetjen dhe thotë: Dera ime nuk është e mbyllur, por ti, që nga momenti i besimit në Allahun e ke marrë çelësin e afërsisë me Allahun dhe nëse do Allahu kurrë nuk të lë anash dhe ti qëndron gjithmonë me Allahun, kështu që:

- përsërite takimin sa të duash,
- qëndro në prezencën e Tij sa të duash dhe
- kërko çka të duash.

Mirëpo ,ndryshe është situata me ata të cilët janë më pak të rëndësishëm (me njerëzit). Ata (njerëzit) kur të na thërrasin, edhe pse na japin diçka prej kohës së tyre, ne, nëse dëshirojmë takimin me ta, i përgjigjemi thirrjes së tyre, e nëse nuk dëshirojmë nuk i përgjigjemi, vetëm se nëse i përgjigjemi ftesës së tyre, ata e përcaktojnë kohën, e përcaktojnë vendin, e përcaktojnë temën e bisedës, mirëpo (sa i përket takimin me Zotin), Zoti i Lartmadhëruar thotë:

Çelësin e ke ti:

- më tako mua, në cilën kohë të duash,
- më kërko çka të duash,
- nuk e anuloi takimin me ty ashtu siç veprojnë udhëheqësit tuaj, të cilët i anulojnë takimet me të tjerët, përderisa,
- Unë nuk mërzitem me adhurimin që dhuron emocione tek njerëzit,
- lë gjurmë të pashlyeshme tek popujt dhe
- ndikon te njerëzit të shpenzojnë jetën e tyre për të më adhuruar me adhurim të singertë.

Adhurimi ndaj njeriut i cili është i ngjashëm me ne, pra adhurimi ndaj krijesave të Allahut, është i turpshëm dhe i ithët. Pse?

(Përgjigjja) Sepse:

- zotëria e merr të mirën e robit të tij, mirëpo
- adhurimi ndaj Allahut nuk është e kësaj natyre sepse bën që rob i të merr të mirat e Zotit të tij.

Kështu pra,

- adhurimi i njeriut ndaj njeriut është i hidhur sepse merret e mira e robit prej zotërisë, përderisa
- adhurimi ndaj Allahut, Zotëria, Allahu i Lartmadhëruar të jep të mirat e Tij. Për këtë arsye të diturit kanë thënë:

**Më mjafton mua nderi sepse unë jam rob
e takoj Zotin pa termin.**

**Ai është në pozitën më të lartë
dhe unë e takoj kur të dua dhe ku të dua.**

Tani varet nga ju, kur të besosh në Allahun, të pranon. Dëshira e Allahut është në korelacion me dëshirën tënde. Më përkujto Mua, të të Përkujtoj ty. Kush dëshiron ta Përkujtoj, më përkujton Mua. Mjetin e ke ti në dorë:

“Unë jam në mendimin e robit Tim.

Unë jam me të kur më përkujton Mua.

Nëse më përkujton në vete, e kujtoj në veten Time.

Nëse më kujton në publik, e kujtoj në një vend publik më të lartë.

Nëse më afrohet një pëllëmbë, i afrohem një hap.

Nëse më vjen duke ecur, i afrohem më shpejtë.”

Hadith kudsij

Adhurimi në Allahun është mjet për t'u afruar dhe për të marrë fitimin

Adhurimi në Allahun është adhurim i begative, nuk duhet të ndihet turpërim prej saj. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë:

لَنْ يَسْتَنْكِفَ الْمَسِيحُ أَنْ يَكُونَ عَبْدًا لِلَّهِ

“Mesihu nuk tërhiqet prej asaj se është rob i All-llahut.” (En-Nisa: 172)

Që do të thotë: O ti i cili i lutesh Allahut, pejgamberët e Allahut nuk janë turpëruar që të jenë robër të Allahut, nga shkakut se adhurimi të jep krenari, adhurimi nuk lejon të mbizotërojë rrena dhe shpifja, duke thënë se: **“Ai (Isa) është Zot ose ai (Isa) është i biri i Zotit.”** Për këtë arsye, kur Zoti i Lartmadhëruar na ka paraqitur ngjarjen e Israsë dhe Miraxhit çka ka thënë?:

سُبْحَانَ الَّذِي أَسْرَى بِعَبْدِهِ

“Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës.” (Isra: 1)

Adhurimi është mjet për t'u afruar te Allahu. Zoti i Lartmadhëruar e ka paraparë që kur rob i bën një kërkesë në namaz dhe nuk i përgjigjet, ndoshta rob i mendon se namazi i tij është i pavlefshëm dhe ndoshta Zoti i Lartmadhëruar nuk e ka dëgjuar dhe pas kësaj fillon të dyshon, fillon të krijojë iluzion, a ndoshta Zoti veçse ia ka pranuar lutjen, por ia ka vonuar që ta testojë. Thonë se: Sprova (testi) në Allahun është mëdyshje. Përderisa ti testohesh me Allahun, ti je në mëdyshje. Po ashtu, kur ti e lut Zotin dhe Ai nuk të jep çka dëshiron ti, dije se ai është duke vepruar me ty, paralel me botëkuptimin tënd dhe urtësinë e Tij ndaj jush.

Ti ndoshta përderisa je në sexhde të namazin tënd kërkon diçka. Robi më së afërti me Zotin është kur qëndron në sexhde. E lut (Zotin) dhe nuk të përgjigjet, pra nuk e plotëson dëshirën tënde, mirëpo në fakt, në bazë të çështjes së besimit (akaidit) të është përgjigjur sipas urtësisë së Tij dhe nuk të është përgjigjur ty sipas urtësisë tënde. Si?

(Përgjigjja) Nëse djali yt të thotë: Dëshiroj të ma blesh një revole. Ti frikohesh se ai duke lozur me atë revole mund të vrasë ndonjë njeri. Pas një kohe i thua qetësohu. Ti nëse vepron kështu, ti i ke dhënë më shumë se

ç'dëshiron ai sepse ai ka dashur të lozë dhe të zbavitet, mirëpo në esencë nuk i ke përmbushë dëshirat e tij sepse ju jeni frikësuar nga e keqja, e duke e larguar nga dhënia (e revoles), në fakt ti e ke larguar nga e keqja.

Kur je duke e lutur Allahun në namazin tënd dhe nuk të është përgjigjur, ta dish se nuk të është përgjigjur në bazë të botëkuptimit tënd, mirëpo Zoti të është përgjigjur në bazë të urtësisë së Tij. Për këtë arsye, për të na qetësuar, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَيَدْعُ الْإِنْسَانُ بِالشَّرِّ دُعَاءَهُ بِالْخَيْرِ ۖ وَكَانَ الْإِنْسَانُ عَجُولًا

“Njeriu lutet për të keq dhe për të mirë. Njeriu është i ngutshëm.”
(El-Isra: 11)

Njeriu thotë: Më jep këtë, sepse ai e mendon se është e mirë për të, por faktikisht është e keqe për të. Kur Zoti i Lartmadhëruar e ka penguar nga e kërkuara, Ai e ka penguar nga e keqja, mirëpo ai mendon se nuk i është përgjigjur kërkesës së tij. Allahu i është përgjigjur dhe i ka dhënë të mirën, por ajo e mirë është siç e sheh Ai dhe jo siç e sheh dhe e mendon ti. E gjithë kjo është burim i përmirësimit të adhurimit të sinqertë ndaj Allahut.

Namazi është mjet për shoqërinë dashamirëse

Adhurimin të cilin e ka paraparë Allahu, pra adhurimin e namazit, e ka paraparë që të jetësohet në shoqëri dhe të përfitohen çështjet si në vijim:

E para: Fisnikërimi i kohës, ashtu siç fisnikërohet në pasuri dhënia e zekatit.

E dyta: Devotshmëria, sepse personin me personalitet e vëren të nënshtruar, të përlur duke iu frikësuar Zotit.

E treta: Dëgjueshmëria, sepse dëgjueshmëria për çdo ditë përsëritet nga pesë herë.

Nëse dëshiron të kërkossh shoqëri ideale, atëherë shiko se si vepron me këto tri çështje. Për këtë arsye, kur Zoti i Lartmadhëruar ka dashur të na e sqarojë dallimin në mes të shoqërive në vlerë dhe zhvillim, na ka treguar

- dymbëdhjetë forma të ndara në dy grupe,
- secili grup nga gjashtë cilësi dhe
- secila nga dy lloje dhe
- secili lloj nga tri forma.

Nëse i analizon të gjitha shoqëritë e kësaj bote, mund ta vësh se asnjëra prej tyre nuk mund të dalin jashtë nga këto tri çështje të cilat i treguam, e ato janë:

- **respektimi i kohës;**
- **devotshmëria; dhe**
- **dëgjueshmëria.**

Çka thotë Zoti i Lartmadhëruar? Zoti i Lartmadhëruar në hadithin kudsij thotë:

“I dua tri kategori, por tri kategori tjera i dua më shumë; dhe i urrej tri kategori, por tri kategori tjera i urrej më shumë.

E dua të moshuarin e devotshëm, por më shumë e dua të riun e devotshëm.

E dua të pasurin bujar, por më shumë e dua të varfrin bujar.

E dua të varfrin modest, por më shumë e dua pasanikun modest.

E urrej të riun e pandershëm, por më shumë e urrej plakun e pandershëm.

E urrej të varfrin koprrac, por më shumë e urrej pasanikun koprrac.

E urrej të pasurin mendjemadh, por më shumë e urrej të varfrin mendjemadh.

Në hadithin **“I dua tri kategori, por tri kategori i dua më shumë...”** janë tri kategori të cilat janë të ndarë në dy grupe:

E para: tri kategori janë në komperativ;

E dyta: tri kategori janë në superlativ.

Pa dyshim se kategoritë e superlativit janë në shkallë më të lartë se të komperativit. Kështu pra, gjashtë kategoritë e gradës së të dashurve janë të ndarë në dy grupe.

Grupi i parë: **“Të dashur”**.

Grupi i dytë: **“Më të dashur”**.

Po ashtu në pjesën **“i urrej tri kategori, por urrejtja më e madhe është në tri kategori tjera”**. Edhe këto kategori janë të ndarë në dy grupe:

E para: **“Të urryer”**.

E dyta: **“Më të urryer”**.

Nëse dëshiron të kategorizosh një shoqëri prej shoqërive, duhet t'i radhitësh në katër shoqëri, e ato janë:

- **shoqëria e të dashurve;**
- **shoqëria e më të dashurve;**
- **shoqëria e të urryerve;**
- **shoqëria e më të urryerve.**

Kur Zoti i Lartmadhëruar ka treguar në këtë hadith kudsij, i ka përmendur **“të dashurit”**, pastaj i ka ngritur në nivel më të lartë **“më të dashurit”**.

Po ashtu i ka përmendur **të urryerit**, pastaj ka sinjalizuar për gradën më të ultë **të të urryerve**.

“I dua tri kategori, por tri kategori tjera i dua edhe më shumë.”
Këto tri elemente i shohim se janë elemente të cilat rezultojnë nga namazi.

Si qëndron çështja për tri kategoritë e para?

Në tekstin **“E dua të pasurin fisnik, por të varfrin fisnik e dua më shumë”**. Kjo nga shkak se kur i pasuri bëhet fisnik, bëhet për shkak të pasurisë së tij, ndërsa kur i varfëri bëhet fisnik, fisnikëria e tij është e ndërlidhur me veten e tij. Edhe pse është i varfër, ai me varfërinë e tij tregon fisnikërinë. Shiko shoqërinë e të varfërve, ata janë modest, por si është çështja me gjendjen e të pasurit? Ata do të jenë më fisnikë.

Në pjesën e tekstit **“E dua të varfrin e devotshëm, por më shumë e dua të pasurin e devotshëm.”** Kjo nga shkak se devotshmëria e të varfrit mund të ndodhë për shkak të gjendjes së varfërisë së tij, mirëpo i pasuri posedon arsye të shumta që të tregohet arrogant. Kjo nënkupton se i pasuri hyn në kategorinë e **më të dashurve**, ndërsa i varfri në kategorinë e **të dashurve**.

Sa i përket pjesës **“E dua plakun e devotshëm, mirëpo të riun e devotshëm e dua më shumë”**. Kjo është një çështje e cila përkon me natyrshmërinë e forcës së tij, pra dobësisë së tij. Nuk i ka ndjenjat e zjarra. Nuk ka forcë të madhe, përderisa i riu i cili i plotëson të gjitha këto elemente, mirëpo prapë se prapë ai është i devotshëm. Kjo shoqëri është shoqëria **më e dashur**. Pra, shoqëria më e ngritur është ajo e cila e ka:

- të moshuarin e devotshëm;
- të varfrin fisnik;
- të riun e dëgjueshëm.

Përderisa shoqëria e dashur (e mirë) është shoqëria e cila e ka:

- të pasurin fisnik;
- të varfrin e devotshëm;
- plakun e dëgjueshëm.

Sa i përket gjashtë kategorive tjera.

Në pjesën e tekstit **“I urrej tri kategori, por tri kategori tjera i urrej më shumë.”** Si është gjendja e tyre?

- **E urrej të varfrin koprrac, por të pasurin koprrac e urrej më shumë.** I varfri i cili tregohet koprrac, ndoshta tregohet koprrac për shkak se ka pak pasuri apo për shkak të nevojave të tij, mirëpo i pasuri nuk ka arsyetim për koprracinë e tij.

- **E urrej të pasurin kryelartë, por të varfrin kryelartë e urrej më shumë.**

- **E urrej të riun mëkatarë, por plakun mëkatarë e urrej edhe më shumë.**

Kjo është çështje e logjikshme dhe buron vetëm nga Zoti fisnik. Kategorizimi logjik është normal dhe i përshtatshëm me logjikën njerëzore.

Kështu pra, ne i kemi katër lloje të shoqërive. Nëse i analizojmë të gjitha shoqëritë e kësaj bote, do të shohësh se dallojnë nga njëra-tjetra, në bazë të cilësive të atyre shoqërive. Vlera e tyre vlerësohet në bazë të këtyre cilësive. Kur Zoti i Lartmadhëruar na e paraqet këtë, a thua çka kërkon prej neve?

(Përgjigjja) Nga ne kërkon:

- Nëse nuk jemi në kategorinë e **më të dashurve**, së paku të jemi në kategorinë e **të dashurve**.

- Nëse kërkon që të jemi në kategorinë e të dashurve, a do të thotë se nuk duhet të jemi në kategorinë e më të dashurve? Jo! Parashtrohet pyetja, pse?

6. Kategoritë e njerëzve në namaz

Kategoritë e njerëzve në takim me Zotin gjatë namazit të tyre ndryshojnë në aspekt të furnizimit, ndryshojnë njëra nga tjetra varësisht sa kohë shpenzon robi duke qëndruar para Zotit dhe sa është i përkushtuar në atë kohë.

Nëse shohim shpërblimin, shpërblimi caktohet varësisht prej shpenzimit të kohës, mirëpo njerëzit dëshirojnë që Zoti i Lartmadhëruar t'u paraqitet atyre në jetën e tyre siç dëshirojnë ata. Pse?

(Përgjigjja) Nga shkaku se kandari në mendjet e tyre është kandari i tokës (matjes njerëzore) dhe kandar i mendjeve të njeriut.

Shumica e njerëzve nuk kanë dëshirë të jenë borxhdhënës. Ata dëshirojnë që Zoti të jetë borxhlarës i menjëhershëm dhe mendojnë se ***“devotshmëria patjetërsisht duhet të jep përfitimin (frytin)”***. Po të ishte vetëm koha e kësaj bote, kjo do të ishte e drejtë, por përderisa ekziston edhe një kohë tjetër (koha e botës tjetër), atëherë shpërblimi duhet të transferohet edhe në botën tjetër.

Nëse shpërblimi nuk të jepet në këtë botë, mos u dëshpëro, do të të jepet në botën tjetër. Ndoshta rezervimi i shpërblimit për botën tjetër është më i dobishëm se sa të marrësh shpërblimin në këtë botë sepse e mira në këtë botë bëhet me kompensim, ndërsa e mira në botën tjetër është më shumë se sa me kompensim.

Kështu pra, kandari i njerëzve duhet t'i nënshtrohet kandarit të Zotit të Lartmadhëruar. Që nga momenti kur njeriu i nënshtrohet Zotit, duhet që ta dëgjojë Zotin e tij, duhet t'i zbatojë urdhrat e Tij, duhet t'i kryej obligimet me vullnet dhe kënaqësi, atëherë për adhurimin e tij ndaj Allahut shpërblehet. Por ka të atillë të cilët dëshirojnë që nëpërmjet namazit t'u shtohet begatia dhe risku (furnizimi), mirëpo mendoj se kryerja e obligimit ndaj Allahut është që robi të prezantojë para Zotit të tij, e pas kësaj, begatia e Zotit qëndron varësisht prej qëndrimit të njeriut me Zotin. Nëse na ndodhë diçka e padëshiruar në jetë, besimi ynë në falje të namazit nuk duhet të lëkundet dhe afrimi me Allahun nuk duhet të lëkundet. Pse?

A është i vështirë adhurimi dhe pse?

A është i vështirë adhurimi dhe pse?

(Përgjigjja) Nga shkak se çështjet shkojnë paralelisht me urtësinë e Zotit. Në fillim njeriu nuk i pranon këto urtësi, mirëpo kushtet dhe rrethanat e mëvonshme ndikojnë që çështjet ta tregojnë realitetin e tyre.

Kur do diçka, në fund të asaj çështje të cilën e do thua ***“E kam dashur këtë çështje, por në fund prej saj gjeta të keqen”***, ose thua ***“E kam urryer këtë çështje, por në fund prej saj e gjeta të mirën”***.

Kështu pra, krahasimet duhet t'i përshtaten njëra-tjetrës, sepse ti je i krijuar, mendja jote është e kufizuar, urtësia e mendjes tënde është e mangët. Përderisa në çështjet të cilat ndodhin mbi ty pa dëshirën dhe pa vullnetin tënd, mendja jote duhet t'i nënshtrohet urtësisë së Zotit. Pasi që çështja qëndron kështu:

- nëse të godet ndonjë e keqe për shkak të neglizhencës tënde në atë çështje, ti je i mallkuar, përderisa,

- nëse të godet ndonjë e keqe në çështje në të cilën nuk ke kompetencë, duhet të jesh i sigurt se Allahu ka paraparë urtësi për atë çështje. Kur të konkretizohet ajo urtësi dhe kur të realizohet qëllimi i saj, nuk do të kishe dashur asgjë tjetër përpos asaj çka e ka caktuar Allahu për ju.

Ne si njerëz, pse nuk e pranojnë të jemi të devotshëm dhe pse e pranojmë të bëjmë mëkate. Pa kurrfarë dyshimi se në devotshmëri dhe në kryerje të obligimeve ka vështirësi dhe ngarkesë:

... وَإِنَّهَا لَكَبِيرَةٌ إِلَّا عَلَى الْخَاشِعِينَ

“Dhe ajo është çështje e madhe, përpos për të devotshmit.” (El-Bekare: 45)

Njeriu pason epshin dhe dëshirat. Epshi dhe dëshirat kërkojnë nga njeriu që të shkëputet nga programi. Devotshmëria është ajo e cila e ndërlidhë njeriun me program. Epshi i njeriut nuk dëshiron ndërlidhje, por dëshiron shthurje, mirëpo ti shiko atë i cili dëshiron të ndërlidhet me ty. E, Zoti yt është Ai i cili dëshiron të ndërlidhet me Ty. Përderisa Zoti është Ai i cili ndërlidhet me ty, Ai të jep ty në këtë botë dhe pastaj ti nuk e shikon kohën e kryerjes së obligueshmërisë dhe se kur Zoti do të të shpërblejë (jep) ty dhe anasjelltas kur Zoti të ndalon ty të veprosh një çështje, Ai në të njëjtën kohë e ka ndaluar gjithë shoqërinë që të mos e veprojë atë ndalesë kundrejt jush.

Çka është ajo e cila e bën të vështirë kryerjen e obligimit?.

(Përgjigjja) Kur ta falin namazin, e falin me përtaci, sepse nuk e shohin shpagimin e kryerjes së obligimit në kohën e kryerjes së veprimit, po sikur ta kishe paraparë shpagimin (shpërblimin) në momentin e kryerjes së veprimit dhe ta kishe paraparë kërkesën dhe shpërblimin para vetes me bindje të plotë, asnjëherë nuk do ta kishe vonuar kryerjen e obligimeve.

Gjithashtu, po të ishte paraparë dënimi i mëkatit në kryerjen e mëkatit në të njëjtën kohë dhe të bëhej krahasimi në çast, atëherë kurrë nuk do të mëkatohej.

Shembull:

- Nëse një njeriut i cili dëshiron të bëj prostitucion i afrohet një femër e bukur, i përgatitet një vend, por i thuhet, vepro si të duash me këtë, mirëpo shiko këtë dhomë, dhe ia hapim derën e dhomës në të cilën është i ndezur një zjarr i madh përcëllues (për t'u hedhur). Cili do të kishte qenë qëndrimi i tij?

(Përgjigjja) Kur ta llogaritë vuajtjen e dënimit, mendoj se as që do t'i shkonte mendja kurrë për mëkatim (prostitucion).

Kështu është çështja edhe me besimtarin:

- Nëse për çdo kryerje të obligimit do të parashihej shpërblimi, ai do të pranonte devotshmërinë dhe do të largohej nga mëkatimi. Në këtë mënyrë duhet kuptuar konceptin: ***“Lapërdhari nuk bën prostitucion përderisa është besimtar.”*** që do të thotë: Ai i cili beson, ndodhë që e harron dënimin e botës tjetër, mirëpo kur e vendos në kandarë dhe e analizon, atëherë ai nuk pranon të bëjë mëkat:

Lapërdhari nuk bën prostitucion duke qenë besimtar;

Alkoolisti nuk pi alkool duke qenë besimtar;

Hajni nuk vjedh duke qenë besimtar.

Dhe nëse ndodhë, kjo nënkupton neglizhencën e shpërblimit për kryerje të obligimit, e neglizhon çështjen që:

- për kryerje të obligimit pason shpërblimi, ndërsa,
- për mos kryerje të obligimit pason dënimi.

Esenca e besimit

Kur besimtari dëshiron ta konceptojë esencën e besimit, duhet ta konceptojë ashtu siç ka ndodhur kur pejgamberi s.a.v.s. e ka pyetur Hudhejfen r.a., të cilit i tha: Si je zgjuar?

Hudhejfe r.a. iu përgjigj: Jam zgjuar besimtar në Allahun?

Pejgamberi s.a.v.s. i tha: Çdo realitet e ka esencën e saj, e cila është esenca e besimit tënd?

Hudhejfe iu përgjigj: E kam mënjanuar veten time nga kjo botë, për mua thesaret dhe gurët e saj janë të njëjta, dhe më duket sikurse i shikoj banorët e xhenetit në xhenet duke shijuar mirësitë në xhenet dhe sikurse i shikoj banorët e xhehenemit në xhehenem duke u dënuar.

Pejgamberi s.a.v.s. i tha: E ke kuptuar, kështu vepro.

Përderisa ti qëndron në një vend dhe çështjet janë të qarta dhe çështjet e padukshme te ti janë të dukshme dhe bindëse, atëherë duhet të dish se ky është kuptimi bazë i yti për qëndrimin para Zotit dhe kryerjes së obligimeve ndaj Tij. Atëherë çdo gjë në këtë botë për ty është e bukur, përderisa nuk e bën të shëmtuar. A nuk e keni dëgjuar thënien:

Nuk është e mundur të jetë më mirë se ajo e cila është.

Dhe, çka është bukuria?

A nuk është bukuri ajo të cilën e zbukuron shpirti.

Shpirti e zbukuron të keqen dhe mëkatin. Etika e kësaj bote qëndron në atë kur rezultojnë rezultatet dhe vërtetohet e vërteta në gjithësi varësisht prej atributit bazë të saj. Në shkollë kemi nxënës të zellshëm dhe jo të zellshëm. Cila është etika e shkollës? A është etike të jenë të suksesshëm që të gjithë apo etike është të kalojnë të zellshmit dhe jo të zellshmit të përsërisin vitin?

(Përgjigjja) Po që se kalojnë me sukses që të gjithë, atëherë etika do të ishte te të dobët dhe jo të zellshmit, mirëpo etika asnjëherë nuk qëndron në ndodhitë e rastit sepse kjo do të nënkuptonte se etika bazohet vetëm në një individ dhe në një rast i cili nuk përsëritet, pasi që kur të arrijmë në vitin vijues të gjithë do të thoshin, pse të angazhohemi, pse të lodhemi, pse të mundohemi, pse të zgjohemi herët në mëngjes e të shkojmë në shkollë dhe të kthehemi në mesditën e nxehtë dhe t'i verbërojmë sytë duke lexuar

përderisa të gjithë do të kalojmë vitin?! Kështu pra, esenca e etikës e humb vlerën në tërësi. Pse?

(Përgjigjja) Nga shkaku se një individ e merr pjesën (fatin) e etikës siç dëshiron ai individ.

Etika në Gjithësi (Vasionë) është ajo të cilën e sheh syri.

Në gjithësi (Vasionë) nuk ka asnjë të keqe e cila nuk e ka edhe një dobi. Përderisa kemi çështje të cilat nuk kanë asnjëherë asnjë të keqe, si f.v., ajri, yjet në gjithësi, erërat, në këto dukuri njeriu nuk ka kompetenca dhe këto dukuri nuk mund t'i kontrollojë. Shko shiko në malet e larta ku ka egërsira, atje nuk ka të keqe, por kur aty shkel njeriu, sheh diçka habitshme dhe të dëmshme në të. Kështu pra, në çdo çështje në të cilën nuk ndërhyt njeriu, vazhdon të qëndrojë e kthjellët dhe harmonike dhe e pastër. Pse ndodh kjo?

(Përgjigjja) Kjo ndodhë nga shkaku se njeriu e ka të drejtën e përzgjedhjes sipas epshit të tij. Njeriu i prish këto çështje edhe po qe se ajo e keqe i dëmton miliona njerëz.

Esenca e etikës

Etika e vërtetë është që rezultati përfundimtar të jetë në harmoni me gjendjen paraprake të saj.

(Shembull):

Nëse e sheh një rrugë në të cilën njerëzit janë të ndotur dhe e sheh se në atë rrugë ka mbeturina të mbushura me miza dhe mushkonja. Po të mos kishte miza (mushkonja), atëherë do të ishin të barabarta shtëpia e pastër me shtëpinë e papastër dhe aty nuk do të kishte barazi (drejtësi) sepse: ***“Është e patjetërsueshme që para çdo shtëpie të papastër të ketë miza (insekte)”***.

(Po të mos ishte kështu) Kjo nuk do të konsiderohej drejtësi dhe barazi, nga shkakut se para çdo shtëpie të papastër është patjetërsueshme të ketë miza.

Kështu pra, çdo vepër e mangët e njerëzve krijon dhe paraqet të keqen në shpirt, sepse etikë e të keqes është që rezultatet e të keqes në vetvete të jenë të këqija.

(Shembull tjetër):

Nëse mbahet konkurs (garë) e karikaturistëve botërorë për të paraqitur portretin e shejtanit në karikaturë dhe në atë konkurs (garë) marrin pjesë një milion karikaturistë. Në fund, kush do të fitonte vendin e parë?

(Përgjigjja) Vendin e parë do ta fitonte ai i cili e paraqet portretin e shejtanit në formën më të keqe të mundshme sepse në konkurs nuk kërkohet forma e meikut.

Kështu pra, etika e vërtetë është që rezultati të jetë në harmoni me gjendjen paraprake të saj.

Nëse e shohim një popull i cili e lë pas dore programin e Zotit të vet, e lë pas dore fenë e vet dhe mbetet i prapambetur, kjo do të ishte etike dhe e drejtë.

E kundërta e kësaj,

po që se e sheh një popull i cili i përmbahet programit të Zotit të vet, a nuk do të ishte etike që ky popull të jetë i zhvilluar. Nuk mund të shohësh një popull i cili nuk i përmbahet programit të Zotit të vet e të vazhdojë të jetë i zhvilluar.

Kështu pra, etika e cila paraqitet në gjithësi është etika e cila nuk paraqitet me dëshirën dhe përzgjedhjen e njeriut, por me forcën e urtësisë së

lartë, ashtu që t'u sqarohet të gjithë njerëzve, se kush kundërshton urdhrat e Tij, përfundimin do ta ketë kështu dhe kështu. Për këtë arsye, ata të cilët e posedojnë këtë fakt, e analizojnë veten e tyre, dhe kur prej tyre merret diçka e dashur, thonë **“Kjo çka më ka mbetur është më e mira.”**

Ka ndodhur njëherë, kur Abdullah ibn Xhaëfer kishte shkuar në Damask për të takuar udhëheqësin e besimtarëve Hisham bin Abdul Melikun. Gjatë rrugës prej Medines deri në Sham, shkelë në një mbeturinë dhe e lëndon këmbën. Kur arrin në Damask, për shkak të infektimit i përkeqësohet plaga. Udhëheqësi i besimtarëve i thërret mjekët për mjekim. Ata i thonë se duhet t'i amputohet këmba. Shkojnë për t'ia prerë këmbën deri në gju. Udhëheqësi i besimtarëve u thotë: injektojani këmbën - ashtu sikurse në ditët e sodit siç bëhet anestezioni.

Abdullah ibn Xhaëfer thotë: Jo për Zotin, nuk dua për asnjë çast të më mungojë përmendja ndaj Zotit tim. E zgjat këmbën dhe ia amputojnë. Cili njeri mund ta përballojë këtë vetëm për shkak se nuk dëshiron që të larg Zotit të tij?

Pas kësaj, e marrin pjesën e këmbës për ta pastruar, pastaj e mbështjellin për ta varrosur.

Ai u thotë: Ma sillni këmbën (e prerë).

Ia japin këmbën.

Ai e merr në dorë dhe thotë: ***“Nëse jam sprovuar me një organ të trupit tim, atëherë jam i kursyer nga organet tjera.”***

Duke e thënë këtë fjali, i vjen një lajm se djali i tij kishte qenë në kulmin e kështjellës së udhëheqësit të besimtarëve dhe duke e zgjatur kokën për t'i vështruar kuajt, i kishte peshuar trupi dhe kishte rënë në tokë dhe kishte vdekur. Atëherë Abdullah bin Xhaferi thotë: ***O Zoti im, nëse më ke sprovuar me djalin tim, Ti m'i ke kursyer djemtë tjerë.***

Kështu pra, ai nuk ka shikuar çka është marrë prej tij, por ka shikuar se çka i ka mbetur.

Kështu pra, besimtari kur të pranon caktimin e Zotit ndaj tij, ai e pranon urtësinë e atij përcaktimi, ai e sheh etikën në çdo çështje.


Përderisa ai e sheh etikën në çdo çështje, ai e ka vërtetuar në veten e tij urtësinë e Atij i cili ka krijuar.

Përderisa e ka vërtetuar urtësinë e atij i Cili e ka krijuar, atëherë e mëshiron Ai i Cili e ka krijuar.


Përderisa i vlerëson çështjet të cilat e godasin, çfarë qëndrimi ka Zoti në atë rast?

(Përgjigjja)

- Ai është Zoti i Cili e do.
- Ai është Zoti i Cili dëshiron që të përfitohet prej Tij.
- Ai është Zoti i cili dëshiron që shtëpitë e Tij (Xhamitë) të mbushen me adhurim, me përkujtim dhe me mësim.



ZEKATI



Është vazhdim i rrugës së afrimit me Allahun duke u pastruar nga zilia, urrejtja, xhelozia dhe duke e eliminuar të keqen nga vetvetja.

1. Në zekat sigurohet vet jeta

- **Rruga e afrimit me** Allahun të cilit i besojmë është namazi sepse në namaz shpenzojmë një **pjesë të kohës**, po ashtu,

- **Rruga e afrimit me** Allahut të cilit i besojmë është edhe zekati sepse me zekat shpenzojmë një pjesë të **rezultatit të punës**.

Kjo, për të siguruar jetën te të fortët, për të siguruar besimtari jetën e tij dhe të atyre të cilët i ka në përkujdesje. Besimtari nuk duhet ta anashkalojë të dobëtin sepse i dobëti është krijesë për të luajtur rolin që të forcoj jetën dhe nuk duhet që ta humbas këtë të forcojë jetën dhe nuk duhet që ta humbas këtë të dobët sepse i dobëti ka ardhur për të kryer detyrën në këtë botë.

Zoti i Lartmadhëruar i ka bërë dallimet te zemrat e njerëzve që t'ia tërheq vërejtjen njeriut se nuk duhet të mendojë që të bëjë krahasime vetëm me pasuri (mes njerëzve). Para se të bëjë krahasimin me pasuri e jep një pjesë të pasurisë së tij si zekat dhe patjetër se duhet të llogaritë se është duke marrë po aq zekat. E drejtë është që njeriu të analizojë që kur të obligohet për diçka të mos shikojë vetëm çka merret prej tij, por të shikojë edhe çka i jepet atij.

Drejtësia e të urtit është që t'i shikoj të dy anët e çështjes (medaljes) ashtu që Ne (Zoti) marrim nga ju atëherë kur je i aftë, për të ta dhënë kur ti nuk je i aftë. Këtë veprimtari të jetës Zoti i Lartmadhëruar e quan zekat. Allahu e quan zhvillim dhe e quan pastrim.

Nëse shikojmë terminologjitë e ligjësisimit të çështjeve, e shohim se nga aspekti i jashtëm i kanë dy anë të kundërta. Kamatën e cila e shton kapitalin, Allahu e quan **“moszhvillim”**. Kjo sikurse dëshiron të na tregoj se kandari i Allahut ndryshon nga kandari i krijesave. Ai i cili vepron me kamatë i jep njëqind, ndërsa i merr njëqind e dhjetë. Në bazë të përlogaritjes së kandarit tënd quhet **zhvillim (shtim)** ndërsa tek Allahu është **moszhvillim**.

Elementet e zekatit

Zekati i cili e merr një pjesë të kapitalit, e pakëson 100% ashtu që mbeten 97.5%. Ky është pakësim i qartë, por Allahu si e quan zekatin? Si e quan Allahu rritje? Shikoni pra se si ndryshon emërtimi i çështjeve të njerëzit, të cilët i ka krijuar Allahu!! Por në esencë nuk është kështu. Kështu pra, programi i Zotit të Lartmadhëruar ka për qëllim udhëzimin dhe ngritjen e vetëdijes së njerëzve në kuptimin e realitetit të çështjeve.

Qëllimi i kamatës është se shpie në “**moszhvillim**”.

Qëllimi i pakësimit të pasurisë me zekat ngërthen në vete tre elemente:

- **zekatdhënësi - e ai është pronari i kapitalit;**
- **zekatmarrësi - është shpenzues;**
- **zekatdhënia - është çdo lloj pasuri, pra pasuria.**

Këto janë tri elemente. Si mund të jetë zekati zhvillim dhe pastrim i këtyre tre elementeve?

Në rend të parë, e marrim elementin e zekatdhënësit, i cili është element reflektues në procesin e zekatit dhe i cili e vendos ekonominë në lëvizje. Zekatdhënësi ndonjëherë e neglizhon fitimin e ndonjë pjese të kapitalit të tij dhe merr diçka e cila është hamendësim i fitimit haram. I kërkohet zekati që ta pakësojë dhe që ta pastrojë nga ai neglizhim, mirëpo parashtrohet pyetja: Si i shtohet pasuria?

Ne i themi atij: A besojmë se rritja në çështje është shtesë vetëm e asaj çështje? Njerëzit nuk kanë njohuri në përcaktimin e furnizimeve, sepse njerëzit e shohin vetëm anën e **furnizimit (rizk) pozitiv (aktiv)**. Kjo nënkupton se furnizimi pozitiv ka të bëjë vetëm me atë çka e shton kapitalin. Ky është furnizim në bazë të botëkuptimit të tyre dhe ata nuk e shohin **furnizimin (rizk) negativ (pasiv, të padukshëm)**. Çka nënkuptojmë me furnizimin negativ?

(Përgjigja) Ta marrim një shembull:

Një person i cili të hyrat i ka 100 euro, mirëpo Zoti ia mundëson që të përfitojë në shpenzime sikurse t'i kishte harxhuar 150 euro, ndërsa

një person tjetër i cili e ka furnizimin (të hyrat) 100 euro, Allahu e pengon dhe ai përfiton gjësende në vlerë prej 50 eurove.

Në bazë të statistikave e shohim se ajo çka është më pak është më e vlefshme.

Kështu pra:

- kemi furnizimin i cili quhet **furnizim pozitiv**, e cila është shtesë në bazë të shikimit të të ardhurave dhe,

- furnizimin i cili quhet **furnizim negativ (pasiv)** i cili është pakësim nga të ardhurat.

Ndonjëherë ti hyn në shtëpi. Bashkëshortja të thotë: Djali ka temperaturë të lartë, ndërsa Allahu vendosë qetësi në zemrën tënde nga shkaku se furnizimi yt është hallall. Për shkak të përkujdesjes së Allahut për ju, ka mbjell mirësi dhe qetësi, ashtu që me bindje i thua bashkëshortes: Jepja një aspirin, një gotë me ujë me liman.

Kështu, me pak shpenzim përfundon çështja.

Në anën tjetër, një person fiton pasuri në mënyrë të pandershme dhe që në momentin kur i thuhet: Djali yt ka temperaturë të lartë, ai thotë, çka është kjo ditë e pafat apo çka është kjo kështu dhe shkon te mjeku, ashtu që shpenzon pasuri, shpenzon kohë dhe shpenzon mund të madh. Nëse e llogarit fitimin javor të tij se sa ka përfituar nga njerëzit, aq sa ka përfituar prej tyre duke i mashtruar, aq ka shpenzuar për atë sëmundje! Sepse të Përgjithmonshmin asnjëherë nuk e zë as gjumi dhe as dremitja.

Kjo është madhështia e Allahut ku thotë: ***O ju njerëz (krijesa), flini në vendet e juaja sepse Unë nuk flejë dhe asnjëherë nuk do të ju lë pas dore sepse Mua nuk më zë as gjumi as dremitja.*** Kush mashtron, ai ka mashtruar veten e tij. Të vërtetën e ka thënë Zoti i Lartmadhëruar:

يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَمَا يَخْدَعُونَ إِلَّا أَنْفُسَهُمْ وَمَا يَشْعُرُونَ

“E mashtrojnë Allahun dhe besimtarët, por ata e mashtrojnë vetëm veten e tyre por nuk e ndjejnë.” (El-Bekare: 9)

قُلْ هَلْ نُنَبِّئُكُمْ بِالْأَخْسَرِينَ أَعْمَالًا ﴿١٠٣﴾ الَّذِينَ ضَلَّ سَعْيُهُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَهُمْ يَحْسَبُونَ أَنَّهُمْ يُحْسِنُونَ صُنْعًا

“Thuaj: A të ju tregoj se cilët janë humbësit më të mëdhenj të veprave? Janë ata të cilëve u humbë angazhimi (shpërblimi i veprave) i kësaj bote, ndërsa ata mendojnë se kanë vepruar mirë.” (El-Kehf: 103, 104)

Njeriu fatlum, prej një euroje përfiton, pastaj qesh dhe është i lumtur për këtë dhe për atë, i regjistron dhe vepron, pastaj autorizon tjetrin që të nënshkruaj për të, tjetri fsheh nga shteti dhe nuk i regjistron (të hyrat dhe të dalat për të ju shmangur tatimit). Duhet të dish se e ke Zotin i cili të kontrollon. A nuk e kupton se ai i cili është me të, i kontrollohen regjistrat? Gjithsesi jo?

Kështu pra, për jetën, **furnizimi negativ (pasiv)** është më i rëndësishëm. Për këtë arsye shumica e njerëzve jetojnë të sigurt dhe të qetë dhe të qëndrueshëm e stabil, pas kësaj i shohim se këta dëshirojnë t'i edukojnë fëmijët si është më së miri, po ashtu të jetojnë të lumtur. Njerëzit habiten dhe thonë: Si jetojnë këta?

(Përgjigjja) Këta jetojnë në bazë të kodit **të furnizimit negativ** (pasiv) dhe jo në bazë të kodit të **furnizimit pozitiv (aktiv)**.

Përpos kësaj ekzistojnë edhe kode tjera te Zoti i Lartmadhëruar.

Kur të jepet zekati, a do të thotë se ka rritje kapitali. Zekati tërheq nga ju shpenzimet, ndërsa kapitali shtohet. I ke pasur 100 euro dhe tani të kanë mbetur 97.5 euro. Por Zoti i Lartmadhëruar ka penguar nga ju, ashtu që kur i ka tërhequr nga ju një pjesë të shpenzimit, ti i merr 50 euro dhe i bie sikurse i ke pasur 100 euro dhe pas zbritjes së 2.5 eurove, janë bërë 150 euro. Kështu pra, kapitali është rritur dhe nuk është pakësuar. Kjo quhet shtim i kapitalit. Kjo është nga elementi i parë i zekatdhënësit.

Në zekat qëndron shërimi i zemrës prej zilisë dhe urrejtjes

Sa i përket zekatmarrësit, edhe tek ai qëndron pastrimi dhe shtimi i pasurisë. Kjo nga shkakun se zekatmarrësi është i dobët. Ai e shikon më të fortin dhe mund të aktivizohet energjia e urrejtjes, zilisë, nënçmimit (ndaj të fortit), mirëpo kur ta shoh njeriun të cilit Zoti i ka dhënë begati dhe pastaj ai e zgjat dorën e ndihmës dhe ndihmon me atë që e ka begatuar Allahu, thotë: *“Begatia në të më ka begatuar edhe mua”*.

Kështu pra, urrejtja dhe zilia zhduket dhe nuk ekziston dhe e pastron veten e tij sepse i jepet pasuri, deri sa ai është i paaktivizuar dhe i dobët dhe aktivizohet në jetë. Ai (zekatmarrësi) në shoqërinë e besimit është plotësues dhe ai nuk i pranon ndodhitë e jetës i vetmuar.

Kështu pra, zekatmarrësi bëhet pjesë zëvendësuese forcuese për vëllezërit besimtarë dhe të atyre të cilët qëndrojnë rreth tij. Pra, ai nuk brengoset për ndodhitë e jetës përderisa ekzistojnë njerëzit të cilët ndërlidhen me të, të cilët janë vëllezër të besimit. E mira te ata është e shumëllojtë. Ky është zhvillimi i burrërisë së tij, zhvillim i personalitetit të tij dhe zhvillim i forcës së tij.

Përderisa, nëse njerëzit shpëputen prej tij dhe ai e shoh se ballafaqohet i vetëm me jetën dhe qëndron i izoluar, atëherë nuk mund të ketë zhvillim as në burrërinë e tij dhe as në shpresën e tij. Mirëpo kur të paraqiten njerëz të cilët i ndihmojnë, ai e kupton se nuk është i vetëm në jetë, ai e zhvillon veten e tij, pastaj kur zekatmarrësi ta shijojë ëmbëlsirën e marrjes nga zekatdhënësi, i cili ia ka lehtësuar vështirësitë, atëherë zhvishet nga zilia dhe urrejtja dhe po ashtu ai vet duhet të angazhohet për jetën e tij, punon, dhe po ashtu edhe vet e shijon ëmbëlsirën, por edhe të tjerët e shijojnë ëmbëlsirën.

Kështu pra, Zoti i Lartmadhëruar zekatin e ka ligjësuar për pastrim dhe zhvillim edhe pse në aspekt të jashtëm thonë se është pakësim. Ne themi: jo, kursesi jo! Kjo është në bazë të kandarit (përlllogaritjes) tënd, mirëpo kandari (përlllogaritja) i Zotit është mbi kandin (përlllogaritjen) tënd. Kur njeriu aktivizohet dhe në mendjen e tij qëndron aktivizimi për veten e tij dhe për të dobëtit, sigurohet dhe e gjen garancën se nëse dobësohet varësisht prej ndryshimeve dhe rrethanave shoqërore do të ketë njerëz të cilët do të aktivizohen për veten e tyre dhe për atë gjithashtu. Ky është sigurimi i jetës, pasi që njeriu beson në atë çka e frikëson në jetën e tij.

2. Zemra dhe organet tjera fizike të njeriut

Kur Zoti i Lartmadhëruar e ka ligjësuar ligjin e besimit, në atë program ia ka bashkëngjitur faktorët e jetës. Përderisa në atë program ua ka siguruar ushqimet e jetës, u thotë atyre: ***“Mos e stresoni veten në çështje të rizkut (furnizimi) duke i shkaktuar zemrës vështirësi”***.

Sa i përket çështjes përfundimtare të rizkut (furnizimi), ka dallim në mes të:

- ngarkesës së trupit tënd dhe,
- ngarkesës së zemrës tënde.

Ndoshta risku (furnizimi) është i garantuar në tokë:

- Nëse je i fortë, shkon deri te caku dhe e gjen, ndërsa,
- nëse je i dobët, te caku i furnizimit shkon vëllai yt besimtar i cili angazhohet për veten e tij dhe për ty.

Kështu pra, në këtë çështje garantues është planprogrami i Allahut. Përderisa në këtë çështje garantues është planprogrami i Allahut, njeriu nuk duhet ta ngarkojë zemrën, mirëpo këtu nuk bën pjesë ngarkesa e pjesëve të trupit.

Ka njerëz të cilët nuk e bëjnë dallimin në mes të këtyre dy çështjeve. Nëse dëgjon dikë i cili të ndalon që ta ngarkosh veten për çështjen e riskut (furnizimit), thuaj, qëllimi është të mos ngarkohet zemra dhe të mos mundohet shpirti (e kjo nuk ka të bëjë me ngarkimin e organeve tjera fizike).

Besimtari posedon:

- zemrën dhe
- pjesët tjera fizike.

Pjesët fizike të trupit lodhen, por zemra mbështetet te Zoti. Ky është dallimi mes tyre. Pjesët e trupit punojnë, ndërsa zemra mbështetet te Zoti. E gjithë kjo është çështja e besimtarit. Ai i cili të thotë mos u mbështet te Zoti, ti thuaji: Jo, nuk është si thua ti.

Po ashtu, ai i cili të thotë: Zoti i Lartmadhëruar të furnizon (të jep riskun) ashtu siç e furnizon shpendin, i cili fluturon i uritur dhe kthehet i ushqyer. Ti kundërpërgjigju dhe thuaji: A fluturon në mëngjes dhe a kthehet në mbrëmje!?. Edhe pse shpendi nuk është i obliguar (me obligime si njeriu), ai shkon (fluturon) dhe kthehet.

Tevekul dhe Tevakul

Përderisa ata të cilët nuk e pranojnë të vërtetën dhe pretendojnë se mbështetja në Zotin është përtaci, në esencë nuk është asgjë tjetër përpos mbështetje në Zotin. Për këtë arsye, ne u kundërpërgjigjemi dhe ndonjërit prej tyre i themi: Do të të shpërblejmë me diçka të thjeshtë. Do të ju shtrojmë një tryezë (sofër), në të do të të shërbejmë dhe do të shtrojmë çka të doni dhe çka jua ka ëndja. Ti duhet të mbështetesh në Zotin dhe të mos e zgjatësh dorën, por lejoje (prit) ushqimin të kërcej në gojën tënde.

Pse në këtë nuk mbështeteni në Zotin!?

Ju gënjeni në atë që pretendoni!?

Ju jeni mbështetur në atë që e ngarkon trupin e juaj, ndërsa në esencë duhet të ngarkoni fizikun e juaj dhe t'i qetësoni zemrat e juaja. Kjo quhet **mbështetje në Zotin**. Për këtë arsye shohim se si Allahu i ka paraqitur “të frikësuarit”. Në këtë botë shpëtojnë dhe kanë siguri të frikësuarit!? (Është shprehur siguri) Për ata të cilët frikësohen nga dy çështje:

- frikën se do të ndëshkohen nga qeveritarët;
- frikën nga çështja e furnizimit (rizkut).

Për këtë arsye:

الَّذِي أَطْعَمَهُم مِّنْ جُوعٍ وَآمَنَهُم مِّنْ خَوْفٍ

“Ata të cilët i ushqen nga uria dhe i siguron nga frika.” (El-Kurejsh: 4)

Ky është burimi i cili e vështirëson të gjithë botën, e Zoti i Lartmadhëruar thotë: Largohuni nga ata, Unë ju siguroj prej tyre dhe angazhohuni në punën tuaj pa ata.

Konceptin e kësaj çështjeje, për të barazuar kandin shoqëror, Zoti i Lartmadhëruar e sjell në hadithin kudsij, ku thotë:

O biri i Ademit, mos u frikëso prej qeveritarit përderisa sundimi im nuk përfundon.

O biri i Ademit, mos u frikëso nga vështirësia dhe ngushtimi i furnizimit (rizkut), përderisa magazinat e mia nuk zbrazen asnjëherë.

O biri i Ademit, mos kërko diku tjetër pos Meje sepse Unë jam Allahu, nëse më kërkon, do të më gjesh, nëse largohesh nga Unë, Unë largohem nga ti, dhe atëherë do t'i humbësh të gjitha të mirat.

O biri i Ademit, të kam krijuar për adhurim dhe mos neglizho (mos luaj), të kam garantuar furnizimin (riskun) dhe mos e ngarko veten... deri në fund të hadithit.

Këtu është përdorur fjala **“mos u ngarko”**, dhe ka për **qëllim të ngarkuarit e zemrës**. Për këtë arsye në të kaluarën kanë thënë: Nuk ka të bëjë me ngarkesë të trupit, pra atë që e bartë trupi. Atë që e bartë shpina nuk quhet ngarkesë. Mirëpo parashtrohet pyetja: Çka quajmë “ngarkesë”?

Ngarkesë quhen vështirësitë të cilat e rëndojnë zemrën dhe ajo që vendoset brenda kraharorit (jo shpinë).

Puna e besimtarit është mirësi për krijesat e Allahut

Kështu pra:

- Në rend të parë Zoti i Lartmadhëruar ka kërkuar nga robërit e tij të punojnë për veten e tyre, ndërsa,

- në rend të dytë për t'i plotësuar nevojat e të tjerëve.

Besimtari veçohet në atë se punon edhe për të dobëtin i cili nuk mund të punojë.

Dallimi në mes të besimtarit dhe pabesimtarit qëndron në këtë aspekt (kuptim) sepse pabesimtari është i barabartë me besimtarin në atë se:

- pabesimtari punon në këtë botë për plotësimin e nevojave të tij dhe për plotësimin e nevojave të familjes së tij, përderisa,

- parimi i besimit është që besimtari të punojë edhe për aktivitet tjetër, e ajo është që të zgjerojë aktivitetin e tij për të dobëtin dhe të paaftin të cilët janë krijesa të Allahut.

I dobëti dhe i paafti janë prej krijesave të Allahut. Çdo begati prej begative nuk është ashtu siç e mendojnë njerëzit por janë specifike në shoqëri, ato begati kanë ardhur që gjithmonë të përmirësojnë besimin e njerëzve për atë begati prej begative. Kështu pra, ai ka detyrë në jetë dhe kjo detyrë nuk duhet të mungojë për shkak të tij. Për këtë arsye është obligim për besimtarin të jetë aktiv në këtë botë, të punojë punë që të jetë e mjaftueshme për të dobëtin (të paaftin) të cilin Zoti i Lartmadhëruar e ka bërë si shembull për të tërhequr vërejtjen për begatitë e Allahut në krijesat e Allahut. Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَالَّذِينَ هُمْ لِلزَّكَاةِ فَاعِلُونَ


“Dhe ata të cilët në zekat (institucionin) veprojnë.” (El-Muëminunë: 4)

Kjo nënkupton se ata nuk konsiderohen veprues (të zekatit) apo dhënës të zekatit, pos nëse vepra e tyre është për qëllim për të (dhënien e zekatit) që të merr nga nevojat e tyre për t'u përkujdesur për të dobëtin i cili nuk mund të veprojë. Kështu pra, puna e tyre duhet të jetë me njetin e dhënies së zekatit të tjetrit.


Zoti i Lartmadhëruar kur na ka sqaruar islamin me shtyllat e saj, ka dashur që të jetë në kontinuitet afria me Allahun, një të Vetëm. Dëshiron kontinuitetin se nuk ka transmetues për Allahun përpos të dërguarit të

Allahut. Dëshiron që të vulos kuptimin e robërimit ndaj Allahut dhe adhurimin dhe që të na bashkojë të gjithëve në namaz në përulmëni dhe na urdhëron që të veprojmë me veprim të trefishtë:

- **për veten;**
- **për familjen;** dhe
- **për të dobëtin, të paafatin.**



AGJËRIMI



*Është rruga e cila e forcon afrimin me Allahun dhe është rruga e cila
forcon ndjenjat duke adhuruar Allahun.*

1. Vendi i besimit

Jeta i ka ligjet e veta, jeta e ka krenarinë e adhurimit. Dëshirojmë që besimtarin ta specifikojmë në dy çështje.

Ndonjëherë ndonjë njeri:

- Jeton dhe kurrë nuk sheh alkool. Pra kurrë në jetën e tij nuk mund të sheh alkool. Kjo për shkak të vendit besimtar në të cilin jeton dhe nuk i shkon ndërmend për alkool për shkak se nuk gjendet pranë tij.

- Jeton dhe nuk i shkon ndërmend që të konsumojë mishin e derrit.

- Jeton dhe nuk vjedh sepse jeton në një shoqëri harmonike e cila nuk e edukon për një gjë të tillë.

(Në këto raste) Largimi nga çështjet e ndaluara (haramet) për njeriun ndoshta është gjë normale, pra e ka të lehtë për ta larguar veten nga haramet dhe është lehtë për të qenë fisnik dhe adhurues ndaj Allahut. Për këtë arsye, qëllimi i besimtarit është që të mos e ndryshojë traditën për të adhuruar me adhurim Krijuesin.

Tani (në Ramazan) situata ndryshon. Ai duhet të abstenojë nga çdo gjë dhe ai gjithmonë duhet të mendojë se ka abstenuar si praktikim i urdhëresave të Allahut dhe jo për shkak të asaj se normaliteti dhe natyrshmëria e tij e ka penguar nga kjo, ose nga ajo, si f.v.: për personin i cili agjëron, por agjëron për shkak se mjeku ia ka rekomanduar se agjërimi e shëron nga ndonjë sëmundje dhe nuk agjëron si adhurim. Për këtë arsye, **adhurim** quhet atëherë kur e pranon se Allahu të ka urdhëruar, dhe jo atëherë kur çështja është se ti ke ndonjë nevojë për atë adhurim i cili të fton që të veprosh këtë apo atë.

2. Kulminacioni i ndjenjave është në kryerjen e obligimeve dhe në adhurim

Esenca e adhurimit është se njeriu duhet ta përfjoshë adhurimin. Për këtë arsye, ka ndonjë vepër e cila mund të jetë e barabartë me adhurimin, por nëse ajo vepër është pa nijet të adhurimit ndaj Allahut, atëherë ajo është e pavlefshme.

Devotshmëria është që dëgjueshmëria në shpirt të burojë nga ajo çka është normale dhe e zakonshme dhe kur njeriu të ndalohet nga adhurimi. Allahu ka dashur që të përcaktojë shtyllë prej shtyllave të islamit që të ndalojë robin në çështje të cilat ia ka lejuar gjatë gjithë vitit.

Natyrshmëria tregon se duhet të ushqehemi dhe të pimë ujë gjatë ditës, mirëpo Zoti i Lartmadhëruar ta ndalon atë. Ta ndalon atë edhe pse është e lejuar në raste (ditë) tjera. Pse?

(Përgjigjja) Nga shkaku se duhet të vazhdosh për të arritur në kulminacionin e ndjenjave me adhurim, kur je duke i kryer obligimet. Zakonisht ti në atë kohë hanë dhe pinë dhe nuk largohesh nga bashkëshortja gjatë ditës së muajve tjerë përpos muajit të agjërimit. Pse?

(Përgjigjja) Që të kthehesh në krenarinë duke adhuruar dhe duke qenë zbatues i adhurimit të asaj çështjeje. Frikësohesh që të të dominojë zakoni dhe të ndalon ato ndjenja me fuqinë e adhurimit. Ashtu ka dashur Allahu i Lartmadhëruar që të të përcaktojë një muaj në vit që të të ndalojë gjatë ditës së atij muaji atë që ta ka lejuar gjatë muajve tjerë të vitit ashtu që njeriu të ndjejë se është i urdhëruar me një çështje të re.

Kështu pra, muaji i Ramazanit është adhurim i ngritjes. Nocioni i urdhërimit të ngritjes është se:

- gjatë muajve tjerë (përpos muajit Ramazan) gjithmonë lejohen ato çështje (të ndaluar), ndërsa

- në Ramazan gjithmonë ndalohen ato çështje.

Specifikimi i muajit Ramazan është se përfshinë ndalimin e çështjeve të cilat janë të lejuara. Përfshinë çështje të cilat janë të ndaluara në muajt tjerë dhe përpos kësaj i shtohet diçka e re. **Kjo është ngritja (avancim) e adhurimit të besimtari.**

Agjërimi është kontinuiteti i adhurimit fisnik

Niveli më i pastër i adhurimit në të cilin qëndron robi në adhurimin e tij është niveli i muajit Ramazan, e ajo është adhurimi specifik ashtu që të largon nga zakoni i rëndomtë, të ndalon nga ajo që të ka lejuar dhe të thotë: *mos e vepro*, pastaj kur të perëndojë, të urdhëron me urdhër të prerë që të fillosh ngrënien, përderisa në ditët e tjera e ke pasur të lejuar ngrënien. Të është ndaluar dhe të lejohet ushqimi në kohën e pas perëndimit. Kur të fillon thirrja e ezanit e fillon ngrënien pas abstenimit dhe ky është riadhurim dhe nuk është adhurim i ndalimit. Në atë moment kur thërret ezani i akshamit, atëherë ngrënia bëhet adhurim.

Kështu pra, të ka tërhequr nga të gjitha zakonet e rëndomta të jetës tënde dhe nga ajo e cila të ngrit në nivelin më të lartë të zakonit në atë mënyrë dhe e pengon (mohon) nga njeriu zakonin e rëndomtë dhe bëhet ashtu që e merr atë zakon dhe e vendos si ligj të besimit dhe dritë. Për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar e ka zgjedhur kohën e cila është adhurim me vlerë dhe jo zakon i rëndomtë dhe e ka zgjedhur pikën tjetër të ndriçuar ashtu që planprogrami i tij të jetë për të gjithë njerëzimin.

Ti, nëse shikon në agjërimin të cilin e ka ligjësuar Allahu në muajin Ramazan, e sheh se e ka ligjësuar si ligjësim të detyrueshëm, në anën tjetër nuk e ka penguar që të agjërohet në muaj tjerë si agjërim vullnetar nëse sheh lehtësim në trupin tënd dhe qetësim në veten tënde dhe vazhdimësi e ndriçimit tënd, mirëpo ka dallim në mes të çështjes së adhurimit i cili është obligativ dhe çështjes së devotshmërisë e cila nuk ndalohet për ty, por e pranon nga ju nëse është adhurim i llojit i cili është obligim për ju.

Në agjërime qëndron mjeti për robërit të cilët kanë dëshirë për të takuar Allahun

Në njërin anë Zoti i Lartmadhëruar e hap derën për besimtarët për t'u afruar tek ai, mirëpo,

në anën tjetër cakton në masë që të jetë e domosdoshme për të gjithë. Kjo formë qëndron në të gjitha obligimet.

Zoti i Lartmadhëruar kërkon në masë të caktuar atë çka është e domosdoshme për të gjithë, pastaj pjesën tjetër e lë për besimtarët ambicioz të besimit, pra që të jenë të veçantë dhe që të ngrihen lartë, p.sh., nëse një njeri të dëmton. Çështja është që të dënohet aq sa të ka dëmtuar. Kjo është pika e përbashkët për të gjithë njerëzimin, mirëpo kur besimtari dëshiron që të përlogaritë veten e tij me precizitet, a mund të dënojë në të njëjtën masë të dënimit? A mos kam kandar të saktë e cila dëshmon (vërteton) dënimin me të njëjtën masë të dënimit tim?

Kjo çështje duhet të analizohet. Kur të gjendem në këtë situatë pse nuk e mposhti hidhërimin tim!?. Në këtë çështje është dera e ngritjes. Kuptimi i **“mposhtjes së hidhërimit”** është se hidhërimi i cili gjendet në zemrën tënde prej atij i cili të ka dëmtuar, ti nuk reflekton me reflektim që atë hidhërim t'ia kthesh tjetrit.

Pse nuk e nxjerr hidhërimin nga vetvetja dhe t'ia falësh!?. Kur ngrihesh në këtë nivel ngrihesh kur ke vendosur për të mos dëmtuar në të njëjtën masë, kur e ke mposhtur hidhërimin, kur e ke falur dhe e ke ndalur hidhërimin, a nuk do të thotë kjo se në krahasim me tjetrin je ngritur në nivel të lartë të besimit!?

Kështu ne kemi arritur të ëmbëlsia e afrimit me Zotin.

Çka është ai afrim me Zotin?

Në afrimin me Zotin është grada ambicioze e besimit

Për të sqaruar këtë e marrim këtë shembull sepse te Allahu është shëmbëlltyra më e mira.

Një njeri hyn në shtëpi dhe e sheh se njëri prej fëmijëve të tij e ka dëmtuar vëllanë.

Dëshirojmë ta kuptojmë zemrën e prindit në atë moment. Në anën e cilit prej fëmijëve do të qëndrojë?

(Përgjigjja) Në anën e të cilit janë shfaqur reflekset e vuajtjes prej dëmtimit.

Por nga kush i ka ndodhur ajo vuajtje e dëmtimit?

(Përgjigjja) Nga ai i cili e ka dëmtuar.

Vetëm e vetëm për t'ia larguar gjurmët e dëmtimit, prindi do të shikojë mënyra për ta gëzuar djalin e dëmtuar me shpërblime të cilat i ka kërkuar ndonjëherë djali i dëmtuar por që nuk ka mundur t'ia realizojë.

Po të ishte i mençur ai i cili është dëmtuar do të kuptonte këtë butësi, këtë përkëdhelje dhe këtë mëshirë e cila e ka kapluar prindin, do ta kuptonte se vëllai i cili i ka shkaktuar vuajtje është shkaktar për të fituar atë shpërblim, dhe në vend se ta urrej ai duhet të thotë: Jo (nuk e urrej vëllanë), sepse dëmtimi prej tij u bë shkak për të më sjellë dobi edhe më të madhe.

Kështu pra, edhe ai (vëllai) meriton shpërblim me diçka pasi që ai ka ndikuar që prindi im të më dojë, të më respektojë dhe të ketë mëshirë për mua. Për këtë arsye, për lartësimin e besimtarit në nivel të lartë të devotshmërisë, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَالْكَاطِمِينَ الْغَيْظَ وَالْعَافِينَ عَنِ النَّاسِ ۗ وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ

“Dhe ata të cilët e mposhtin hidhërimin dhe falin njerëzit, Allahu i do bamirësit.” (Ali Imranë: 134)

Ti nuk ke bërë mirë, por e ke tejkaluar atë që të ka ndodhur. Për këtë arsye, kur është pyetur Hasan el Basriu, pse më kërkon besimi (imani) që unë të i bëj mirë atij që më ka bërë keq?

Është përgjigjur: A nuk je krijesë e Allahut?

Po – i është përgjigjur.

- Ai i cili të ka shkaktuar vuajtje dhe të ka dëmtuar a nuk është krijesë e Allahut!? Kur të dëmton ai i cili është krijesë e Krijuesit, i cili xhelozon Krijuesin, me çka veçohet?

- Me falënderim.

Kështu pra, ti je më i butë në mes të dy anëve të cilat i ka krijuar Allahu. Ky është veprim për pozitë të lartë, me të cilën ti lartësohesh.

Kur Zoti i Lartmadhëruar e lartëson besimin në muajin Ramazan, ashtu që më ngarkon me një detyrë të re e cila është e lejuar për mua në çdo kohë të vitit dhe ka qenë e rëndomtë ta veprojë, dhe kur agjëroj, Allahu më ka nxjerrë nga ajo gjendje (pozitë) e rëndomtë dhe e cila më forcon ëmbëlsirën e obligimeve rishtazi, ashtu që gjendja e rëndomtë të mos jetë pengesë për të kryer atë obligim apo natyrshmëria e cila e ka pranuar atë natyrshmëri, e ka programuar atë program ashtu që këto çështje nuk më shkojnë ndërmend, për këtë arsye nuk ka vuajtje, nuk ka vështirësi dhe dëshira e Allahut është që në muajin Ramazan ta caktojë këtë obligueshmëri.

Përderisa njeriu gjendet në atë pozitë, për këtë arsye Allahu e ka zgjedhur muajin Ramazan që të jetë një fazë kohore që të zbres programin e tij për të gjithë njerëzimin.

شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنْزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ هُدًى لِّلنَّاسِ وَبَيِّنَاتٍ مِّنَ الْهُدَىٰ وَالْفُرْقَانِ ۚ فَمَنْ شَهِدَ
مِنْكُمُ الشَّهْرَ فَلْيَصُمْهُ

“Muaji i Ramazanit (është muaji) në të cilin ka zbritur Kur’ani, (i cili) është udhëzues për njerëzit dhe sqarues për udhëzim dhe dallues. Kush nga ju prezanton në këtë muaj, le të agjërojë.” (El-Bekare: 185)

Kështu pra, mënyra e renditjes është si në vijim. Në fillim ka zbritur Kur’ani, duhet që të jetë ajo kohë, koha në të cilin realizohet lartësimi i besimit si lartësim ku besimtari shkëputet dhe del nga zakoni i rëndomtë dhe përjeton ëmbëlsirën e adhurimit.

Përfundim

Në çështjen e afrimit me Allahun, Allahu i Lartmadhëruar na urdhëron:

- Që të dëshmojmë se nuk ka Zot tjetër pos Allahut dhe të dëshmojmë se Muhamedi është i dërguar i Allahut;

- Të falim namazin;

- Të japim zekatin;

- Të agjërojmë Ramazanin;

- Të kryejmë haxhin në shtëpinë e Allahut.

Kur Zoti i Lartmadhëruar ia ka ligjësuar të dërguarit të tij në fund agjërimin e ramazanit. Ai e ka ligjësuar për ta ngritur në nivelin më të lartë të obligueshmërisë nga shkaku se vendi dhe familja janë ndjenja të brendshme shpirtërore të njeriut dhe janë pengesa për te Allahu, kështu që na nxjerrë nga ajo gjendje për të na testuar me obligimet me të cilat na ka obliguar. Na ka obliguar që të mësohemi për një kohë të lëmë anash familjen sepse dëshiron që të na kthejë në një udhëtim tjetër, e ai udhëtim është shtylla e pestë e islamit **(të kryejmë haxhin në shtëpinë e Allahut).**

Për një periudë kohore duhet të lëmë anash çdo gjë dhe shkojmë në haxh, në këtë, Zoti i Lartmadhëruar na ka dhënë diçka tjetër që të largohemi nga e rëndomta, pra duke lënë familjen, pasurinë dhe shtëpinë.

Kur të shkojë njeriu në haxh, ai i ka plotësuar pesë shtyllat e islamit dhe të besimit. Ai i cili drejtohet dhe niset të shkojë atje me zemër besimtare dhe me bindje të thellë, atëherë me syrin e tij të sigurt:

- e sheh shtëpinë e Zotit të tij në të cilën drejtohej (në namaz),

- bën Tavaf, dhe

- i kryen obligimet tjera dhe

- në praktikë e përjeton shtëpinë e Allahut dhe të vërtetën e shtëpisë së Allahut.

Nëse i analizojmë të gjitha këto çështje, do të shohim se janë çështje të cilat paraqesin sinqeritetin. Agjërimi për Allahun është bindje e thellë dhe adhurim i sinqertë dhe të gjitha çështjet e pastra islame janë adhurim.

Fillim dhe mbarim, falënderimi i takon Allahut!

Namazi	3
1. Të shprehurit e dashurisë ndaj Allahut në mënyrë të përbashkët është adhurim ndaj Allahut	5
Në namaz bëhet takimi për të madhëruar Allahun.....	7
Në xhemat, Zoti i Lartmadhëruar na tregon suksesin e tregtisë në jetë9	
Produktiviteti i punës për të aftin dhe të paaftin	11
Në aktivitetin jetësor, një pjesë duhet të jetë në rrugë të Allahut	13
2. Afrimi me Allahun	15
Përgjatë aktivitetit të jetës nuk do të thotë se duhet të harrojmë planprogramin e Allahut	17
3. Përmendja.....	19
Në përmendje të atyre të cilët janë me aftësi të kufizuar kemi sqarim për ata të cilët i harrojnë të mirat	20
Dallimi mes njerëzve tregon dobinë prej njëri-tjetrit.....	22
4. Namazi, shoqëria dhe forca në islam	24
Namazi dhe shtyllat e islamit	25
Në shtëpitë e Allahut.....	27
Namazi është takimi me Allahun	29
Namazi është bërë obligim në mënyrë të drejtpërdrejtë	31
Shejtani e prishë namazin e muslimanit.....	33
5. Namazi dhe edukata	35
Namazi dhe urdhri janë Një	37
Namazi është për të nderuar njerëzimin.....	39
Adhurimi në Allahun është mjet për t'u afruar dhe për të marrë fitimin	41
Namazi është mjet për shoqërinë dashamirëse	43
6. Kategoritë e njerëzve në namaz	47
A është i vështirë adhurimi dhe pse?	48
Esenca e besimit.....	50

Esenca e etikës	52
Zekati	57
1. Në zekat sigurohet vet jeta	59
Elementet e zekatit	60
Në zekat qëndron shërimi i zemrës prej zilisë dhe urrejtjes	63
2. Zemra dhe organet tjera fizike të njeriut	64
Tevekul dhe Tevakul.....	65
Puna e besimtarit është mirësi për krijesat e Allahut	67
Agjërimi	69
1. Vendi i besimit	71
2. Kulminacioni i ndjenjave është në kryerjen e obligimeve dhe në adhurim	72
Agjërimi është kontinuiteti i adhurimit fisnik.....	73
Në agjërim qëndron mjeti për robërit të cilët kanë dëshirë për të takuar Allahun.....	74
Në afrimin me Zotin është grada ambicioze e besimit.....	75
Përfundim.....	77

